# Bashkia Shkodër

## Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian

**2017-2020**



BASHKIMI EVROPIAN

Bashkia Shkodër

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

IDM
Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

UNDP
Empowered lives.
Resilient nations.

BASHKIMI EVROPIAN

Bashkia Shkodër

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

IDM
Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

UNDP
Empowered lives.
Resilient nations.

# Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës 2017-2020

*Përgatitja e Planit të Zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës (2017-2020) u mundësua në kuadër të Projektit "Fuqizim Ekonomik dhe Social i Romëve dhe Egjiptianëve – shtysë për përfshirjen sociale" (ESERE), financuar nga BE dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri. Procesi planifikues u asistua nga ekspertët e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në bashkëpunim me Grupin Lokal me Pjesëmarrje të krijuar në Bashkinë e Shkodrës përgjatë muajve Dhjetor 2016-Shtator 2017.*

**Grupi i ekspertëve të IDM-së:**
Elona Dhëmbo
Armela Xhaho
Evelina Azizaj
Shefqet Bruka

**Ekspertët Lokal**
Behije Kodra
Marjus Veizi

**Kryetar i Grupit Lokal të Planit të Zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian**
Filip Vila, Drejtor i Shërbimeve Sociale, Bashkia Shkodër

*Qëllimi kryesor i procesit planifikues është t'u jap grupeve vulnerabël si rom dhe egjiptian një mjet që fuqizon në mënyrë të veçantë grupet në nevojë, duke i bërë ato pjesëmarrëse direkte në vendimmarrje, nëpërmjet dizenjimit të aktivitete konkrete të planit të veprimit për zhvillim nga vetë ata. Kjo bëhet më domethënëse kur planifikimi i zhvillimit synon specifikisht grupet në nevojë, si komunitetet rome dhe egjiptiane, të cilët jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike dhe janë të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse që ndikojnë jetët e tyre, por konkretisht edhe nga një sërë shërbimesh publike.*

*Shkëputur nga Guida (IDM 2017)*

## Grupi lokal me pjesëmarrje për hartimin e planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian

| Emër/Mbiemër | Institucioni | Pozicioni i punës | E-mail |
|---|---|---|---|
| Filip Vila | Bashkia Shkodër | Drejtor i Shërbimeve Sociale | vila.filip@bashkiashkoder.gov.al |
| Jeta Xhabija | Bashkia Shkodër | Përgjegjëse e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale | sherbimetsociale@bashkiashkoder.gov.al |
| Rudina Kruja | Bashkia Shkodër | Pun. Mbrojtja Fëmijëve | rudinakruja@live.com |
| Dhimitri Sovjani | Bashkia Shkodër | Spec. Strehimi | dhimitrisovjani@hotmail.com |
| Vera Gradeci | Bashkia Shkodër | Përgjegjëse e zyrës së Gjendjes Civile | veragradeci@gmail.com |
| Stela Mardusha | Bashkia Shkodër | Specialiste e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit | s.mardusha@yahoo.it |
| Nektar Duma | Bashkia Shkodër | Specialist i Drejtorisë së Zhvillimit të Territorit | nektarduma@gmail.com |
| Vildana Gushta | Këshilli Bashkiak | Anëtar Këshilli bashkiak | vildana.gushta@yahoo.com |
| Lindita Reçi | Këshilli Bashkiak | Anëtar Këshilli bashkiak | Shkolla_perparimi_nr1@yahoo.com |
| Mirele Mataj | Këshilli Bashkiak | Anëtar Këshilli bashkiak | mirelamataj@yahoo.com |
| Vitjola Capaliku | Ndihma Ekonomike dhe Përkrahja Sociale | Përgjegjëse e Drejtorisë | vitjolacapaliku@yahoo.it |
| Entri Caku | DAR Shkodër | Specialist | entricaku@gmail.com |
| Eltjon Boshti | DRSH Shkodër | Punonjës Social | eltjon.boshti@hotmail.com |
| Ilva Gojani | DRSH Shkodër | Specialiste ShP | gojaniilva89@gmail.com |
| Mimoza Kallaçej (Kraja) | Drejtoria Rajonale SHKP | Specialiste e Formimit Profesional dhe Migracionit | mozakraja@yahoo.com |
| Ergys Ivziku | Qendra Komunitare Nr. 1 | Punonjës menaxhimi | gysivziku@hotmail.com |
| Xhulio Haxhija | Qendra Komunitare Nr. 1 | Punonjës menaxhimi | xhulio_haxhija@live.com |
| Shpresa Mirashi | Qendra Komunitare Nr. 4 | Punonjëse Sociale | shpresa.mirashi@yahoo.com |
| Ermira Heta | ESERE/UNDP | Koordinatore Punësimi | ermiraheta@gmail.com |
| Etleva Luli | ESERE/UNDP | Koordinatore Lokale | etleva.luli@undp.org |
| Mirela Boneri | UNDP | Lehtësuese | Mirela.boneri@undp.org |
| Marjus Veizi | IDM | Ekspert Lokal | marjusveizi.irca@gmail.com |
| Behije Kodra | IDM | Ekperte Lokale | behijekodra@hotmail.com |
| Enkeleida Idrizi | Voice of Roma | Koordinatore Lokale | enkeleidaidrizi@gmail.com |
| Helga Smakaj | SOS-fshatrat e fëmijëve | Koordinatore Programi | - |
| Myzejen Velia | Komuniteti Egjiptian | Pa punë | - |
| Olsi Cufi | Të Drejtat e Komunitetit Egjiptian | Sekretar | cufiolsi@yahoo.com |
| Violeta Fushazi | Gruaja në zhvillim | Psikologe | info@gzhsh.org |

# Tabela e përmbajtjes

**SHKURTIME** 8

**HYRJE** 13

**KAPITULLI I. QASJA METODOLOGJIKE** 19

Parimet udhëzuese të planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian 20

Metodologjia 24

Aktorët e përfshirë 25

**KAPITULLI II. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE** 29

Romët dhe egjiptianët në Bashkinë e Shkodrës 30

Regjistrimi civil dhe aksesi në sistemin e drejtësisë 32

Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor 36

Punësimi, arsimi dhe formimi profesional (AFP) 44

Kujdesi shëndetësor 48

Strehimi dhe integrimi urban 51

Mbrojtja sociale 57

Fëmijët në situatë rruge 62

**KAPITULLI III. PLANI I VEPRIMIT** **65**

Deklarata e vizionit 66

Qëllimet strategjike dhe objektivat specifik 67

Matrica 69

**KAPITULLI IV. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT** **97**

**ANEKS** **98**

# Shkurtime

| | |
|---|---|
| AFP | Arsimi e Formimi Profesional |
| DJ | Drejtoria Juridike |
| DBNJSHM | Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse |
| DPSPKB | Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit |
| DSHSS | Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit |
| DNEPAN | Drejtoria për Ndihmën Ekonomike dhe Personat me Aftësi Ndryshe |
| DKARS | Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit |
| DSPKI | Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve |
| DSHPNII | Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës |
| NJMQK | Njësia e Menaxhimit të Qendrave Komunitare |
| DCK | Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve |
| DEA | Drejtoria Ekonomike e Arsimit |
| DAR | Drejtoria Arsimore Rajonale, Shkodër |
| FSDKSH | Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dega Shkodër |

| | |
|---|---|
| IDM | Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim |
| INSTAT | Instituti i Statistikave |
| ISHP | Instituti i Shëndetit Publik |
| KB | Këshilli i Bashkisë, Bashkia Shkodër |
| KE | Komisioni Evropian |
| NjA | Njësi Administrative |
| NjEF | Njësi ekonomike familjare |
| NJMF | Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Shkodër |
| OCR | Observatori për të Drejtat e Fëmijëve |
| OSFA | Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë |
| PBShSh | Paketa Bazë e Shërbimeve Shëndetësore |
| PB | Policia Bashkiake |
| QKEV | Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim |
| QSH | Qendra Shëndetësore |
| SRVB | Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Biznesit |
| SHKP | Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Zyra Shkodër |
| SHQK | Shkolla qendër komunitare |
| UNDP | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| UNICEF | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët |

# Falenderime

Të nderuar,

Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës (2017 – 2020) konfirmon vullnetin politik dhe përkushtimin tonë për të bërë ndryshime pozitive me synim sigurimin e konsolidimit të një qeverisje vendore me vlera të përparuara demokratike, e cila kujdeset për qytetarët e saj pa dallim përkatësie etnike, racore, fetare dhe politike.

Ky plan synon të identifikojë dhe mobilizojë të gjitha burimet në territor për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetesës për komunitetin Rom dhe Egjiptian dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social. Ai përfshin masa konkrete që institucionet përgjegjëse do të ndërmarrin në realizimin e qëllimeve strategjike dhe objektivave specifikë sipas sektorëve respektivë dhe programeve publike.

Procesi për hartimin dhe përgatitjen e këtij dokumenti ka qenë gjithëpërfshirës, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet publike,

organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e Bashkisë së Shkodrës dhe sigurisht me komunitetin. Gjithçka që përmban ky plan vjen si adresim i nevojave të sjella nga komuniteti dhe puna në terren.

Për realizimin me sukses të këtij procesi, dëshiroj të falenderoj të gjithë ata që kontribuan dhe treguan angazhim serioz dhe shumë aktiv në çdo fazë të punës. Falenderime të veçanta shkojnë për partnerët tanë ndërkombëtarë, Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim- UNDP për mbështetjen e bashkëpunimin e vazhdueshëm si dhe për Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim- IDM për ekspertizën dhe gatishmërinë e ofruar.

Ne jemi të gatshëm të vazhdojmë këtë bashkëpunim të mirë me të gjitha institucionet dhe organizatat partnere në zbatimin e Planit të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian me synim integrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës.

**Voltana ADEMI**
**Kryetare e Bashkisë së Shkodrës**





# HYRJE



Plani për Zhvillimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian është një instrument demokratik planifikimi dhe menaxhimi që synon të adresojë në terma afatshkurtra sfidat me të cilat përballen të dy komunitetet duke synuar arritjen e një vizioni që lidhet me një shkallë më të lartë integrimi të anëtarëve të të dy komuniteteve në jetën sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Ky plan shërben si një mekanizëm orientues i veprimeve që aktorët vendorë dhe rajonalë duhet të ndërmarrin për të adresuar sfidat dhe barrierat që pengojnë dy komunitetet në sigurimin e një jete dinjitoze. Dokumenti i planit fillimisht jep një pasqyrë të situatës aktuale të komunitetit Rom dhe Egjiptian lidhur me gjashtë sfidat kryesore (ku jemi aktualisht në lidhje me: a) regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë; b) arsimimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor; c) kujdesin shëndetësor; d) punësimin, formimin dhe edukimin profesional; e) strehimin dhe integrimin urban, si dhe f) mbrojtjen sociale).

Pas analizës së situatës aktuale, plani propozon vizionin për zhvillimin e dy komuniteteve (se si duam ta shohim komunitetin Rom dhe Egjiptian pas 7-10 vitesh) dhe cili është itinerari për të arritur aty ku dëshirojmë në të ardhmen, ose me fjalë të tjera, plani i veprimit që adreson sfidat sipas gjashtë fushave prioritare. Plani i veprimit paraqet qëllimet strategjike dhe objektivat specifike për gjashtë fushat, ndërsa çdo objektiv ka të renditura projektet dhe hapat e veprimit konkret, të cilat janë të detajuara në lidhje me ndarjen e përgjegjësive ndërmjet aktorëve lokalë dhe rajonalë, implikimet financiare, burimet e të ardhurave, si dhe treguesit e performancës dhe afatet kohore. Zbatimi i hapave të veprimit në përputhje me afatet kohore dhe treguesit e synuar duhet të monitorohet dhe të raportohet.

PZHK është një instrument praktik dhe relativisht i thjeshtë për t'u përdorur jo vetëm nga aktorët publikë (administrata lokake e bashkisë dhe e institucioneve të tjera vendore të dekoncentruara si Drejtoria

Arsimore Rajonale, Fondi Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik, policia, etj.), por edhe nga aktorët e shoqërisë civile, grupet e ndryshme sociale, në kontributin e tyre për adresimin e sfidave sipas veprimeve të parashikuara në Plan, duke bërë të realizueshëm edhe vizionin e artikuluar në dokument. Koordinimi i përpjekjeve ndërmjet aktorëve lokalë për zbatimin e këtij plani është tejet i rëndësishëm duke marrë në konsideratë faktin që një dokument i tillë reflekton nevojat dhe preferencat e anëtarëve të dy komuniteteve dhe të aktorëve të tjerë lokalë. Procesi planifikues ka siguruar hapësirë që anëtarët e dy komuniteteve të kenë një zë në vendimet që ndikojnë zhvillimin e tyre dhe se ndërhyrjet për zhvillim janë të përshtatshme me nevojat dhe preferencat e tyre. Procesi i hartimit të planit ka patur natyrë të lartë pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse dhe dokumenti final është rezultat i konsultimeve të gjera me aktorë publikë dhe jopublikë që veprojnë në sektorë të ndryshëm.

Pikërisht identifikimi i (dis)avantazheve të vazhdueshme me të cilat përballen këto komunitete dhe orientimi i politikave vendore në funksion të përfshirjes dhe zhvillimit socio-ekonomik të komuniteteve vulnerabël kërkon një ndërhyrje efektive ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe në nivel vendor. Plani strategjik nuk është vetëm një parakusht për të mobilizuar burime të tjera financimi dhe akses në fonde nga donatorë të ndryshëm, por edhe një tregues tepër i rëndësishëm në përpjekjen për të rritur mirëqenien, integrimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për këto grupe në nevojë. E thënë ndryshe, politikat në nivel vendor të orientuara drejt përfshirjes sociale kanë një efekt pozitiv jo vetëm në adresimin e nevojave dhe sfidave me të cilat përballen këto komunitete, por edhe më tej në integrimin e qëndrueshëm në fushat prioritare, si: punësimi, arsimimi, strehimi, mbrojtja sociale, shëndetësia.

Plani i Zhvillimit të Komuniteteve rome dhe egjiptiane në Bashkinë e Shkodrës fokusohet në trajtimin e gjashtë sfidave të identifikuara edhe në

Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, por të lidhura më ngushtë me kontekstin vendor. Ky plan zhvillimi është hartuar me synimin që të shërbejë si instrument për orientimin e përpjekjeve ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe në lidhje me integrimin social-ekonomik të dy komuniteteve në Bashkinë e Shkodrës. Njohja e mirë e potencialeve dhe sfidave me të cilat përballen dy komunitetet në 6 fushat prioritare: regjistrimi civil dhe aksesi në sistemin e drejtësisë, arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe formimi profesional, strehimi dhe integrimi urban si dhe mbrojtja sociale, arrin të mbulojë dhe adresojë gamën e gjerë të problematikave shumëdimensionale të të dy komuniteteve.

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë. Në kapitullin e parë përshkruhet qasja metodologjike e procesit planifikues të këtij dokumenti, parimet e planit, modeli konceptual i procesit planifikues sipas fazave, instrumentet e përdorura, duke vënë theksin edhe te aktorët e përfshirë në këtë proces. Në kapitullin e dytë paraqitet situata aktuale e Komuniteteve rome dhe egjiptiane në Bashkinë e Shkodrës sipas gjashtë fushave prioritare të përmendura më sipër. Kapitulli i tretë paraqet deklaratën e Vizionit dhe qëllimet strategjike të planit, i cili vijon me kapitullin e matricës së planit të veprimit që përfshin qëllimet strategjike, objektivat specifike dhe aktivitetet sipas fushave prioritare. Në kapitullin e fundit, rëndësi e veçantë i kushtohet monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit, pasi është tejet e nevojshme dhe e rëndësishme ndjekja e zbatimit të strategjisë për të vlerësuar rezultatet e pritura të objektivave strategjike.

Qëllimi kryesor i procesit planifikues është t'u jap grupeve vulnerabël si rom dhe egjiptian një mjet që fuqizon në mënyrë të veçantë grupet në nevojë, duke i bërë ato pjesëmarrëse direkte në vendimmarrje, nëpërmjet dizenjimit të aktivitete konkrete të planit të veprimit për zhvillim nga vetë ata. Kjo bëhet më domethënëse kur planifikimi i zhvillimit synon specifikisht grupet në nevojë, si komunitetet Rome dhe Egjiptiane, të cilët jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike dhe janë të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse që ndikojnë jetët e tyre, por konkretisht edhe nga një sërë shërbimesh publike.

Shkëputur nga Guida (IDM 2017)



KAPITULLI 1

# QASJA METODOLOGJIKE



# Parimet udhëzuese të planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian

Në thelb të të gjitha nismave në nivel lokal që synojnë integrimin e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian duhet të mbeten të gjitha parimet e mëposhtme, duke vënë theksin në qasjen ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe që kërkohet prej tyre. Si pasojë e nevojës së kësaj qasjeje, ajo çfarë është emergjente dhe kërkohet nga realiteti i aktorëve vendorë në Shqipëri është forcimi i koordinimit mes institucioneve në nivel lokal si dhe partneriteti ndërmjet sektorit publik dhe jopublik.

## 1. Nxitja e përfshirjes sociale

Plani i Zhvillimit të Komunitetit i kushton një vëmendje të veçantë nxitjes së përfshirjes sociale të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Përpos masave të qeverisë shqiptare për integrimin e këtij komuniteti në shoqëri, në përgjithësi ekziston një frymë përjashtuese dhe margjinalizuese duke i bërë këto grupe vulnerabël. Plani orientohet veçanërisht në përpjekjet për të rritur aksesin e romëve dhe egjiptianëve në punësimin formal, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor si dhe në programet e mbrojtjes sociale, në kujdesin shëndetësor, në aksesin në drejtësi dhe strehim me qëllim rritjen e mirëqenies së këtij komuniteti dhe integrimit në jetën sociale dhe ekonomike në komunitetet lokale. Plani promovon parimin e përfshirjes sociale duke i përfshirë vetë anëtarët e grupeve vulnerabël në procesin e planifikimit strategjik.

## 2. Respektimi i dallimeve

Plani i Zhvillimit të Komunitetit respekton dallimet që ekzistojnë ndërmjet komunitetit Rom dhe atij Egjiptian në fushat e ndryshme prioritare. Po ashtu, plani bën dallim edhe midis diferencave që ekzistojnë brenda vetë nëngrupeve të këtyre komuniteteve, duke mos homogjenizuar grupin/komunitetin si një të tërë. Popullata rome në Shqipëri është e

përbërë nga disa nëngrupe/subkultura të cilat dallohen nga njëra-tjetra përgjithësisht nga dialekti, periudha kur kanë mbërritur në Shqipëri si dhe trajektorja e rrugëtimit. Megjithatë, integrimi i dy komuniteteve vazhdon të jetë ende një sfidë në vazhdimësi, e megjithatë plani njeh faktin se disa nëngrupe janë tashmë më të integruara në shoqëri.

## 3. Qasja ndërsektoriale:

Plani i Zhvillimit të Komunitetit vë theksin në nevojën e një qasjeje ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe në mënyrë që përpjekjet për integrimin e dy komuniteteve të sjellin rezultate konkrete. Integrimi në jetën sociale dhe ekonomike të romëve dhe egjiptianëve është i mundur nëse adresohen barrierat e përfshirjes sociale në mënyrë të integruar, pra njëkohësisht në shumë prej sektorëve si: arsimimi, shëndetësia, strehimi dhe integrimi urban, punësimi, arsimi dhe aftësimi profesional, mbrojta sociale, regjistrimi civil si dhe aksesi në sistemin e drejtësisë, duke promovuar zhvillimin dhe integrimin në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme përmes ndërhyrjeve ndërsektoriale.
Zbatimi i planit thekson rëndësinë që merr koordinimi i aktorëve lokalë publik dhe jopublik.

## 4. Dimensioni i integrimit gjinor:

Plani i Zhvillimit të Komunitetit nënvizon rëndësinë e integrimit të dimensionit gjinor në të gjitha hapat dhe proceset e ndërmarra në këtë kuadër. Integrimi gjinor në terma konkrete përkthehet në të dhënat e disagreguara sipas gjinisë dhe në po të njëjtën kohë hartimin e objektivave duke patur parasysh pasojat e tyre për të dyja gjinitë. Për më tepër, plani pranon faktin se gratë rome dhe egjiptiane kanë më shumë gjasa të ndihen të diskriminuara dhe përjashtuara. Kjo, së pari, për shkak të racës dhe së dyti për shkak të gjinisë. Gratë në përgjithësi kanë një qasje më të kufizuar ndaj burimeve ekonomike

dhe të vendimmarrjes, shpesh për shkak të mentalitetit dhe praktikave tradicionale të cilat kontribuojnë në pabarazitë dhe përjashtimin e tyre të vazhdueshëm nga jeta sociale dhe shoqërore. Veprimet e planit kanë një ndjeshmëri gjinore dhe promovojnë arritjen e parimit të barazisë gjinore. Ulja e hendekut të pabarazive midis grave dhe burrave është një element tepër i rëndësishëm i qeverisjes së mirë dhe pritshmërive që BE parashtron ndaj çdo vendi kandidat në lidhje me integrimin gjinor.

## 5. Parimi i Pjesëmarrjes aktive:

Angazhimi konstruktiv i aktorëve lokalë dhe vetë komunitetit Rom dhe Egjiptian në të gjitha hapat e PZHK-së siguron një model të qëndrueshëm të vendimmarrjes pjesëmarrëse dhe efektive. Procesi i hartimit të planit është në funksion të gjithëpërfshirjes ku në mënyrë të veçantë anëtarët e dy komuniteteve ndihen të përfaqësuar përmes anëtarëve të vetë komunitetit në grupin e punës. Procedurat e ndjekura në hartimin e planit sigurojnë gjithashtu një model transparent të demokracisë pjesëmarrëse, ku vetë komuniteti ndihet i mirëdëgjuar përsa i përket vendimeve të cilat do të influencojnë dhe ndikojnë padyshim në vetë cilësinë dhe mirëqenien e jetës së tyre.

## 6. Barazia para ligjit dhe parimi i mosdiskriminimit:

Të gjitha aktivitetet e planifikuara në kuadër të Planit të Veprimit do të kenë në qendër të vëmendjes së tyre respektimin e të drejtave dhe garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimin para ligjit. Parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit qëndrojnë në themel të Kushtetutës së Shqipërisë (Neni 18) si edhe në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, të vitit 1948 (Neni 2). Sipas këtij parimi, çdo individ gëzon të drejtat dhe liritë e përcaktuara pa asnjë kufizim përsa i përket gjinisë, racës, gjuhës, përkatësisë fetare, mendimit politik, origjinës kombëtare e shoqërore, pasurisë, përkatësisë në një minoritet kombëtar, lindjes ose çdo status tjetër social, ekonomik apo arsimor.

## Modeli konceptual: Hartimi i planit të zhvillimit të komunitetit



# Metodologjia

Për hartimin e Planit të Zhvillimit është përdorur një metodologji kërkimore mikse, sasiore dhe cilësore duke u bazuar në të dhëna parësore dhe dytësore të institucioneve përkatëse në Bashkinë Shkodër.
Metodologjia kërkimore përfshin:

1) intervista gjysëm të strukturuara ballë për ballë me anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian;
2) intervista të thelluara me informantë kyç nga institucionet vendore dhe shoqëria civile;
3) fokus grupe me banorë të komuniteteve;
4) sesion i analizës SWOT me anëtarët e nëngrupeve të punës;

4 workshope me grupin e punës duke përfshirë punën në grupe tematike.

*Gjatë sesioneve me anëtarët e Grupit të Punës*



## Aktorët e përfshirë

Identifikimi dhe përfshirja e aktorëve kryesorë në zhvillimin lokal është thelbësore për hartimin me sukses të këtij plani zhvillimi. Duke pranuar se çështja e integrimit dhe fuqizimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian kërkon një qasje ndërsektoriale, shumëaktorëshe dhe gjithëpërfshirëse për vetë kompleksitetin e sfidave dhe problemeve me të cilat përballen, procesi i draftimit dhe konsultimit të planit ka përfshirë aktorë të ndryshëm si nga sektori publik ashtu edhe ai jopublik.

Përfshirja e gjerë e aktorëve përgjatë procesit planifikues është një parakusht i domosdoshëm për të krijuar një model të qëndrueshëm, racional dhe vizionar të planit. Kjo qasje kërkon gjithashtu, një përfshirje edhe më të përgjegjshme në procesin e zbatimit dhe monitorimit të planit me qëllim që plani të mos jetë thjesht një dokument statik, por të lejojë fleksibilitetin e ndërhyrjeve në koherence me zhvillimet/ndryshimet aktuale që paraprin komunitetin. Pra, vizioni për planin është më shumë se një produkt, pasi ai reflekton një qasje më dinamike të mekanizmave institucionalë në nivel vendor për të adresuar/rishikuar me fleksibilitet nevojat në zhvillim.

Grupi lokal me pjesëmarrje i planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian propozohet të ketë përbërjen si më poshtë:

## Grupi Lokal me pjesëmarrje të PZHK

### Këshilli bashkiak & NJQV

- Të zgjedhurit lokal
- 3-4 anëtarë të Këshillit Bashkiak
- 3-5 administratorë të Njësive Administrative

### Stafi kyç i Bashkisë

- Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit
- Drejtoria e financave & buxhetit
- Drejtoria shërbimeve sociale
- Njësia e mbrojtjes së fëmijëve
- Ndihma ekonomike
- Gjendja civile

### Përfaqësues të autoriteteve të tjera publike

- Zyra Rajonale e Punësimit
- Zyra Rajonale e Shërbimit Social
- Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik
- Drejtoria Arsimore Rajonale
- Drejtoria e Policisë
- Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të kujdesit shëndetësor
- Qendra Shëndetësore

### Shoqëria civile & Komuniteti

- 3-5 anëtarë të forumeve të këshillimit të komunitetit
- Përfaqësues nga organizata lokale të shoqërisë civile
- Aktivistë



KAPITULLI 2

# ANALIZA E SITUATËS AKTUALE



## Romët dhe egjiptianët në Bashkinë e Shkodrës

Romët dhe egjiptianët në Shqipëri – nën ndikimin e faktorëve socio-ekonomikë - kanë patur një rritje më të madhe të popullsisë në krahasim me popullsinë në shumicë. Vajzat martohen në një moshë më të re dhe bëhen nëna më shpejt se grupet e tjera etnike. Këto karakteristika formësojnë edhe trende dhe problematika që lidhen me zhvillimin, regjistrimin dhe aksesin në të drejta të këtij komuniteti. Në Bashkinë Shkodër, tradicionalisht kanë jetuar komunitete Rome dhe Egjiptiane. Sipas të dhënave zyrtare, aktualisht, komuniteti Rom dhe Egjiptian zë 0.8 % të popullsisë totale të regjistruar, brenda njësisë administrative Qendër, ku janë të vendosur shumica e tyre. Të dyja komunitetet janë të përqëndruara në këtë njësi administrative, ndërkohë që në të gjitha njësitë e tjera administrative nuk raportohet të ketë asnjë banor/familje (të paktën formalisht të regjistruar) që i takon këtyre komuniteteve. Në total popullsia rome llogaritet të jetë rreth 423 banorë (81 familje) dhe popullsia egjiptiane llogaritet të jetë 1189 banorë (269 familje) kundrejt totalit 204.954 banorë (62.671 familje). Referuar të dhënave nga Shoqata 'Të Drejtat e Komunitetit Egjiptian', popullsia egjiptiane në Bashkinë Shkodër llogaritet të jetë rreth 2200 anëtarë (460 familje).

Për shkak të jetesës kryesisht endacake dhe lëvizjeve të brendshme migratore, komuniteti Rom ka probleme së pari me regjistrimin e vendbanimeve, por edhe më tej me regjistrimin në gjendjen civile.

Niveli i analfabetizmit tek moshat më të mëdha të komunitetit Rom dhe Egjiptian është shumë i lartë, ndonëse ka praktika pozitive të përfshirjes së fëmijëve të këtyre komuniteteve në sistemin arsimor. Veçanërisht problematike është tendenca e braktisjes së shkollës kryesisht pas përfundimit të ciklit fillor në vazhdim të ciklit të lartë të arsimit të detyrueshëm dhe kjo lidhet me mentalitetin e komunitetit ndaj arsimimit; martesat në moshë të hershme etj.

Si pasojë e varfërisë dhe e përjashtimit social nga tregu formal i punës, romët dhe egjiptianët punojnë kryesisht në tregun informal. Ata gjenden më shumë të angazhuar me aktivitete të tilla si mbledhja e hekurishteve, tregtia e rrobave të përdorura, punët e rastit (ngarkim-shkarkim), ndërtim dhe lypje. Megjithatë, edhe këto të ardhura janë të pamjaftueshme dhe në rënie, duke shkaktuar stres dhe pasiguri të mëdha për të ardhmen. Për pasojë, romët dhe egjiptianët përpiqen të migrojnë jashtë vendit, kryesisht në Greqi dhe Itali. Migrimi ndërkombëtar është një nga mekanizmat kryesorë që përdorin romët dhe egjiptianët për përballimin e varfërisë dhe të përjashtimit social. Megjithatë, edhe migrimi i brendshëm është shumë i zhvilluar, problem ky dominues në anëtarët e komunitetit Rom në Shkodër, gjë që kushtëzon dhe shtyn drejt një sërë problematikash të tjera të lidhura me punësimin dhe përfitimin nga programe e shërbime të lidhura me të.

Gjendja shëndetësore e anëtarëve të këtyre komuniteteve ndikohet jo vetëm nga aksesi i ulët në shërbime, por edhe nga parakushtet për një shëndet të mirë si kushtet e banesës dhe ato higjeno-sanitare. Romët dhe egjiptianët në Bashkinë Shkodër kanë akses shumë të ulët në shërbimet sociale të strehimit edhe pse kushtet e vendbanimit dhe ato higjeno-sanitare janë pothuajse jashtë standarteve normale. Për më tepër që vetëm një numër shumë i vogël nga komuniteti përfitojnë nga shërbimet sociale.

Një sërë faktorësh si, gjendja e vështirë ekonomike, kushtet e papërshtatshme të banesave, kequshqyerja, burime të paqëndrueshme të të ardhurave dhe niveli i ulët arsimor e aksesi i ulët shëndetësor ndikojnë drejtëpërsëdrejti në mirëqenien e ulët të këtyre komuniteteve, duke rritur kështu akoma më shumë hendekun e integrimit socio-ekonomik me popullsinë shumicë.

Rubrikat në vijim ofrojnë një panoramë të përgjithshme të situatës aktuale të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës sipas 6 fushave prioritare të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e

Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, të cilat janë: regjistrimi civil dhe aksesi në sistemin e drejtësisë, arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe formimi profesional, strehimi dhe integrimi urban, si dhe mbrojtja sociale.

## Regjistrimi civil dhe aksesi në sistemin e drejtësisë

Pjesa më e madhe e banorëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian janë të përqëndruar në Njësinë Administrative Qendër në Bashkinë e Shkodrës. Sipas të dhënave nga Bashkinë Shkodër rreth 74 anëtarë të komunitetit Rom të përqëndruar kryesisht në zonën e 'Prokurorisë', 'Tophane', 'përtej Urës së Bunës', 'Zalli i Kirit', 'Dubait', të cilët figurojnë të paregjistruar në regjistrin civil. Megjithatë, të dhënat për regjistrimin civil, kryesisht për komunitetin Rom janë shpeshherë kontradiktore, për shkak të lëvizjeve të shpeshta migratore të vetë komunitetit dhe vendbanimeve jo të qëndrueshme.

Edhe pse anëtarët e komunitetit Rom jetojnë në Shkodër që prej më shumë se 10-15 vitesh, vendbanimet e tyre informale dhe të paqëndrueshme bëhen barrierrë për aksesin e një game të gjerë shërbimesh bazë.

Sipas të dhënave nga Karta Rajonale Raportuese, që prej vitit 2011 raportohet për një numër të madh anëtarësh të komunitetit Rom, kryesisht ata që jetojnë në çadra, tenda apo baraka (p.sh pranë lumit Buna - 247 anëtarë; Komuna Bërdicë - 36 anëtarë) që nuk rezultonin të regjistruar në regjistrat e Gjendjes Civile të njësive administrative përkatëse ndonëse janë rezident në këto njësi. Pavarësisht vullnetit pozitiv të Bashkisë Shkodër për të mundësuar regjistrimin e tyre, ende hasin problem me regjistrimin që më pas ndikon edhe në aksesin në shërbime, përfshi atë të arsimimit.

Shpërndarja gjinore e popullsisë rome dhe egjiptiane paraqitet në grafikun në figurën 1.1. Qëllimisht është përdorur një grafik që krahason

shpërndarjen gjinore në komunitetin Rom dhe Egjiptian në Shkodër me atë në shkallë vendi. Kjo e bën lehtësisht të dallueshme hendekun midis të tre komuniteteve. Të dhënat reflektojnë një numër më të lartë të gjinisë mashkullore në krahasim me gjininë femërore krahasuar me trendet e përgjithshme në popullsinë shumicë. Përkatësisht, popullsia rome numëron 235 meshkuj dhe 188 femra, dhe popullsia egjiptiane numëron 575 meshkuj dhe 560 femra. Shifrat që i takojnë komunitetit Egjiptian, e sidomos ato që i takojnë komunitetit Rom, tregojnë për problematika potenciale të abortit selektiv, i cili ka çuar në disa pikë përqindje diferencë në favor të meshkujve në këto komunitete.

**Raporti femra-meshkuj 2017**




*Figura 1: Raporti femra-meshkuj (IDM, 2017)*

Megjithatë, ky është vetëm një pasqyrim i pjesshëm i realitetit. Informacioni mbi popullsinë e paregjistruar mungon. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për komunitetin Rom, për të cilin raportohet nga stafi i Drejtorisë së Shërbimit social se ka një numër familjesh të cilat, ndonëse janë të vendosura në Shkodër, nuk janë të regjistruar në gjendjen civile të kësaj bashkie, por në qytete të tjera si: Fier, Fushë Krujë, Elbasan, Tiranë, Korçë, etj. Janë identifikuar raste të fëmijëve të

këtyre familjeve, që jetojnë prej disa vitesh në qytetin e Shkodrës, që kanë fëmijë të paregjistruar në gjendjen civile si pasojë e moshës së re kur ata bëhen prindër (nën moshën 18 vjeçare), si pasojë e neglizhencës së tyre për regjistrim në gjendjen civile, etj. Aktualisht, pranë Bashkisë së Shkodrës, është krijuar një grup pune për ndjekjen e kësaj çështjeje dhe lehtësimin e regjistrimit të vendbanimeve të familjeve rome në këtë Bashki. Stafi i Drejtorisë së Shërbimit Social do të evidentojë vendbanimet rome në terren, për të cilat do të lëshohet një vërtetim me numrin respektiv të banesës.

**Përfituesit e ndihmës ligjore falas në komunitetin Rom & Egjiptian**




*Figura 2: Aksesi dhe përfitimi nga ndihma ligjore falas (IDM, 2017)*

Për të adresuar hendekun në të dhëna, ekspertë në terren të të dy komuniteteve përkatëse, kanë mbledhur dhe raportuar të dhëna shtesë mbi këto komunitete. Për shumicën e të intervistuarve duket se regjistrimi në gjendjen civile nuk është më një problem madhor. Megjithatë, ata raportojnë që problematika të tilla hasen kryesisht për fëmijë të lindur jashtë vendit, apo për familje ku niveli i informimit është shumë i ulët. Nga të pyeturit, vetëm 1/3 e njohin si problem çështjen

e regjistrimit. Ndërkohë, asistencën ligjore falas për këtë komunitet e njohin shumë më pak dhe vetëm 1/10 e të pyeturve e kanë përfituar. Në aksesin e shërbimeve zyrtare e ligjore ndikojnë edhe eksperiencat dhe perceptimet që anëtarët e komunitetit kanë mbi qëndrimet dhe praktikat diskriminuese/përjashtuese ndaj tyre. Ndonëse më pak se 1/3 e të pyeturve raportojnë të mos kenë hasur ndonjëherë në qëndrime apo praktika të tilla, më shumë se ½ raportojnë të kenë hasur të paktën në një rast diskriminimi në marrjen e shërbimeve.

**A keni hasur ofendim/diskriminim në institucionet lokale?**




*Figura 3: Përballja me diskriminimin në institucionet në nivel lokal (IDM, 2017)*

Disa mënyra sesi shpalosen këto qëndrime dhe praktika raportohen nga vetë të intervistuarit të cilët përmendin format direkte apo indirekte të diskriminimit për shkak të etnisë, ngjyrës.

## Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor

Në Shqipëri niveli arsimor i romëve dhe egjiptianëve u përmirësua dukshëm gjatë periudhës socialiste, si pasojë e masave që u morën për t'i integruar ata në shoqëri. Vendosja e romëve në vendbanimet e qëndrueshme gjatë viteve '60-të, punësimi i plotë dhe i garantuar, strehimi dhe përmirësimi i standardeve të jetesës u pasqyruan edhe në rritjen e nivelit arsimor të tyre. Deri në vitet '80-të u arrit një mesatare shkollimi për komunitetin Rom prej rreth 6.6 klase, por tranzicioni drastik dhe i gjatë i cënoi arritjet edhe në këtë fushë dhe, sot, komuniteti Rom (më pak ai Egjiptian) vuan një raport të përkeqësuar me arsimimin me tregues që shënojnë regres dhe një hendek shumë të madh me nivelet e arsimimit të mazhorancës . Në vite ka qenë mjaft e dukshme një kontradiktë e thellë mes objektivave mjaft ambiciozë të strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të minoritetit Rom dhe kapaciteteve institucionale njerëzore dhe financiare mjaft të kufizuara që janë vënë në dispozicion për realizimin e objektivave. Në krahasim me egjiptianët, niveli arsimor i romëve paraqitet në përgjithësi më i ulët. Sipas studimeve, në Bashkinë e Shkodrës komuniteti Rom vlerësohet të ketë mesatarisht rreth 1 klasë përfshirë analfabetët.

Sa më sipër, në vitin 2011 Observatori Shkodër ka përllogaritur shkallën e braktisjes së shkollës në përqindje: tek fëmijët romë vlerësohej 14.3%, ndërsa e fëmijëve egjiptianë 4.5%. Këto problematika konfirmohen jo vetëm nga të dhënat zyrtare, por edhe nga opinionet dhe qëndrimet e ndara nga të intervistuarit në kuadër të kësaj iniciative.

Në vitin 2016 në Shkodër raportohej të kenë ndjekur vitin akademik rreth 38.5% të fëmijëve të komunitetit Rom dhe 76.2% të atij Egjiptian. Shifrat më alarmante lidhen me numrin e fëmijëve që nuk kanë qenë kurrë në shkollë: 38.5% nga komuniteti Rom dhe 4.8%

nga ai Egjiptian. Këtu vihet re edhe me shumë hendeku midis këtyre komuniteteve dhe mazhorancës, po mbi të gjitha edhe diferenca e thellë midis dy komuniteteve në fokus, atij Rom dhe atij Egjiptian. Problematika kryesore që shoqëron arsimin ka të bëjë me shkallën e lartë të braktisjes së shkollës, kryesisht nga fëmijët romë. Të dhënat nga Drejtoria Arsimore Shkodër tregojnë se përgjatë vitit akademik 2016-2017, nga 141 fëmijë romë të regjistruar në arsimin bazik, rreth 44 prej tyre braktisën shkollën, ndërkohë që nuk raportohet braktisje të shkollës nga fëmijët egjiptianë. Pothuajse e njëjta situatë karakterizon arsimin parashkollor, ku sipas të njëjtit burim informacioni, përgjatë vitit 2016-2017, rezulton se nga 45 fëmijë romë të regjistruar fillimisht në kopshte, 15 prej tyre nuk e frekuentojnë më dhe nga 62 fëmijë egjiptianë rreth 19 e braktisën kopshtin (Raport i Drejtorisë Arsimore Shkodër, Mars 2017). Pra, sikurse evidentohet shkalla e braktisjes së shkollës, kryesisht për komunitetin Rom, si edhe braktisja e kopshtit nga të dy komunitetet mbetet një problem shqetësues për vetë faktin se mungesa e arsimit bëhet një barrierë për të siguruar kushte më të mira jetese në të ardhmen.

Megjithatë, vijueshmëria fizike në shkollë nuk reflekton një arsim cilësor për nxënësit që vijnë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian. Mungesa e duhur e vëmendjes nga mësuesit dhe rezultatet tepër të dobëta të nxënësve në shkollë çojnë në braktisjen e fshehtë të shkollës dhe fenomenin e analfabetizmit pasiv. Sikurse evidentohet edhe nga anketa në terren me anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian, ka një numër të konsiderueshëm nxënësish në klasa, që edhe pse rezultojnë të kenë përfunduar arsimin fillor (apo që vijojnë me arsimin 9-vjeçar), nuk dinë as të shkruajnë edhe as të lexojnë, duke rritur kështu predispozitat për të braktisur më tej shkollën.
Mentaliteti i komuniteteve është jo favorizues në drejtim të arsimimit,

kryesisht të vajzave, duke sjellë një këndvështrim negativ në aspektin e barazisë gjinore. Martesat e hershme dhe të qëndruarit në familje për të mbuluar rolin riprodhues social (përkujdesës) janë nga arsyet kryesore që ndikojnë në këtë praktikë dhe i mban vajzat më larg shkollës. Siç raportohet edhe nga të dhënat parësore, këto diferenca gjinore nuk janë zbehur, por vazhdojnë të qëndrojnë.

Megjithatë ekzistojnë edhe faktorë objektivë që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në frekuentimin ose jo të shkollës. Një faktor i rëndësishëm lidhet me aksesin fizik në institucionet e edukimit (nga çerdhja në shkollë). Të dhënat e UNICEF (2011) mbi përfshirjen sociale të komunitetit Rom ofrojnë një panoramë mbi distancën e institucioneve nga komuniteti Rom në Bashkinë e Shkodrës.

*Tabela 1: Distanca midis institucioneve të edukimit dhe vendbanimeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Shkodër (Beltoje dhe Komunë)*

| | Institucioni | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zona | Çerdhe | Kopësht | Shkollë 9-vjeçare | Shkollë e mesme |
| Komunë Shkodër | 1.1 | 1.1 | 1.2 | 1.3 |

Të dhënat më të fundit nga institucionet përkatëse në Bashkinë e Shkodrës, si dhe intervistat me persona kyç konfirmojnë se problemet e evidentuara në vite përsa i takon komunitetit Rom dhe Egjiptian dhe arsimimit mbeten shqetësuese. Kështu, të dhënat për vitin akademik 2016-2017 nxjerrin në pah dobësinë e madhe në lidhjen e hershme të fëmijëve të këtyre komuniteteve me institucionet e përkujdesit dhe edukimit. Duke iu referuar kopshteve, fëmijët e komunitetit Rom rezultojnë të kenë shkallën më të lartë të shkëputjes dhe mosfrekuentimit (sidomos në kopshtin në lagjen Guerilë dhe Ruzhdi Daca). Fenomeni ndeshet edhe tek fëmijët e komunitetit Egjiptian,

## Nisma për integrimin e fëmijëve Romë dhe Egjiptianë në sistemin arsimor

Mosfunksionimi i ‘Shansit të dytë’, program për arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën që prej viti 2013, penalizon akoma më shumë kontigjentin e fëmijëve të cilët e kanë braktisur shkollën vite më parë apo ata të cilët nuk janë regjistruar asnjëherë në sistemin arsimor bazë. Këta fëmijë, përpos dëshirës për tu integruar dhe vijuar arsimin bazë, përjetojnë një sërë problemesh emocionale dhe paragjykimesh, për shkak se rikthimi në po të njëjtën klasë që kanë braktisur vite më parë (mosha mendore) nuk përkon me moshën e tyre fizike. Të ndodhur përballë një fenomeni të tillë, këta fëmijë detyrohen të braktisin shkollën brenda një kohë shumë të shkurtër.

por në një shkallë më të ulët. Hendeku midis komunitetit Rom dhe atij Egjiptian theksohet me kalimin e viteve, si dhe me kapërcimin nga sistemi parashkollor në atë shkollor. Për këtë vit akademik të dhënat tregojnë për një frekuentim të plotë të shkollës nga fëmijët e komunitetit Egjiptian. Braktisja e shkollës shoqëron sërish komunitetin Rom, veçanërisht në shkollat Xheladi Fishta dhe Ruzhdi Daca.

Problemi i mosfrekuentimit dhe braktisjes së shkollës shkaktohet kryesisht nga zhvendosja e shpeshtë e komunitetit Rom. Transferimi nga një shkollë në një tjetër kërkon procedura të caktuara që nuk e lehtësojnë lëvizjen. Pra, tjetër faktor që ndikon ndjeshëm në braktisjen e shkollës dhe për pasojë në rezultate më të ulëta akademike në mësime, është emigrimi i shpeshtë i familjeve brenda dhe jashtë Shqipërisë. Nga ana tjetër, varfëria dhe kushtet e këqija higjeno-sanitare i bëjnë një pjesë të madhe të fëmijëve të komunitetit Rom të mos jenë në gjendje të vijojnë shkollën. Kjo kontribuon më tej drejt një izolimi dhe përjashtimi shumëdimensional të tyre. Romët që frekuentojnë arsimin parashkollor dhe shkollor, mbështeten nga organizata me vaktin falas në kopshte apo shkolla, por edhe me ndihma të tjera të nevojshme, me qëllim fuqizimin e familjes dhe integrimin e fëmijëve në sistemin parashkollor dhe shkollor. Megjithatë, mungesa e vaktit ushqimor falas në kopshtet publike që frekuentohen nga ky komunitet, nuk favorizon aspak fëmijët e këtij komuniteti të cilët janë të parët që e ndiejnë më shumë mungesën e një shërbimi të tillë për shkak të kequshqyerjes dhe dietës tepër të varfër ushqimore. Në përgjithësi, anëtarët e komunitetit kanë një qasje negative ndaj arsimit, qëndrim i cili mund të ndikojë drejtpërsëdrejti në shkallën e ulët të frekuentimit të të gjitha niveleve të sistemit arsimor. Gjithashtu, arsimimi i ulët prindëror krijon barriera te vetë prindërit të cilët pothuajse nuk janë në gjendje të ndihmojnë dhe lehtësojnë fëmijët e tyre në detyrat passhkolle.

Tek komuniteti Egjiptian, problemi ndeshet më vonë, rreth moshës 12

vjeç, ku tradita e kërkon (veçanërisht për vajzat), që shkolla të ndërpritet. Nëse i referohemi Censusit të 2011 nga INSTAT, rreth 96% e vajzave dhe 68% e djemve romë në moshën 16 vjeç kanë braktisur shkollën. Ndonëse nga shkolla ofrohet shansi i dytë, ai rrallë herë pranohet, pasi kërkohet që të shkohet pranë komunitetit, brenda mjediseve të tyre. Por kjo nuk është gjithmonë e mundur dhe personat kyç të intervistuar argumentojnë se mund të çojë në një segregim edhe më të madh të këtyre komuniteteve nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Të dhënat parësore të përftuara nga intervistat me anëtarë të komunitetit Rom dhe atij Egjiptian (IDM, 2017) gjithashtu i rikonfirmojnë problematikat e sipërpërmendura. Gati gjysma e të intervistuarve (42%) e njohin dhe pranojnë braktisjen e shkollës si një problem të komunitetit të tyre. Por ndër arsyet që listojnë si më të rëndësishme rezultojnë të jenë ato ekonomike, nevoja për të mbështetur prindërit për të fituar para për jetesë, ngacmimet dhe qëndrimet diskriminuese ndaj fëmijëve romë dhe egjiptianë, rezultatet e dobëta në mësime, dhe problemet me gjuhën shqipe. Të pyetur mbi rëndësinë e shkaqeve të cilat çojnë në braktisjen e shkollës nga fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian, pjesa më e madhe e të anketuarve (1/3), kanë vlerësuar nevojën për të mbështetur prindërit për të fituar para për jetesën dhe rezultatet e dobëta në mësime (19%), vijuar me qëndrimet diskriminuese ndaj fëmijëve romë dhe egjiptianë (17%). Në fakt higjiena jo e duhur e fëmijëve romë bëhet pengesa kryesore e frekuentimit të shkollës. Problematika këtu është e dyfishtë: nga njëra anë kemi sjellje përjashtuese nga vetë fëmijët e komunitetit mazhorancë që detyrohen të zhvendosen në klasa të tjera për shkak të higjienës jo të duhur të fëmijëve romë, dhe nga ana tjetër vetë fëmijët romë të ndodhur para fenomenit të diskriminimit apo segregimit detyrohen të braktisin shkollën për të evituar sjellje të tilla segreguese.

Megjithatë, vërehet një zhvillim pozitiv përsa i takon ndërgjegjësimit për rëndësinë e shkollimit dhe gjendjes së tij ndërmjet anëtarëve të komuniteteve në fokus. Ka një ndërgjegjësim të lartë për nivelin e dobët të arsimimit ndër ta, ku 67% e të intervistuarve thonë se arsimimi në komunitetin që bëjnë pjesë është keq ose shumë keq. Për adresimin më të mirë të situatës ata propozojnë mbi të gjitha mbështetje financiare/punësim për prindërit, si edhe ndihmë jashtë shkolle për detyrat e shtëpisë (më shumë se 50% e të intervistuarve).

Ndonëse infrastruktura fizike ka një rëndësi të caktuar ndër faktorët mundësues apo pengues për shkollimin e fëmijëve të këtyre komuniteteve, ajo nuk rezulton të jetë parësore për të intervistuarit tanë. Rreth 38% e të intervistuarve e vlerësojnë mirë gjendjen e shërbimit në shkollën/kopshtin ku shkojnë fëmijët e komunitetit. Pakënaqësitë e tyre nuk lidhen shumë me kushtet fizike dhe infrastrukturore të shkollave, sesa me cilësinë e shërbimit të ofruar, pranimin dhe respektimin e fëmijëve të këtyre komuniteteve nga stafi dhe fëmijët e tjerë. Disa nga përjetimet që ata raportojnë lidhen me situata dhe problematika të cilat kanë të bëjnë me margjinalizimin e fëmijëve, izolimin, trajtimin jo të barabartë dhe të përkushtuar ndaj fëmijëve të tyre, si edhe ofendimet verbale ose jo verbale për shkak të etnisë.

## Promovimi i dialogut ndërkulturor

Arsimi cilësor nënkupton edhe veprimtaritë jashtëkurrikulare apo në komunitet të cilat synojnë ndërgjegjësimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor. Anketimi i zhvilluar nga IDM (2017) tregon se pjesa më e madhe e të pyeturve vlerësojnë se sjelljet e stafit mësimor/edukativ në shkollën/kopshtin e lagjes së fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian janë të një natyre të mirë dhe pozitive (67%), kundrejt vetëm

## Nisma për integrimin e fëmijëve Romë dhe Egjiptianë në sistemin arsimor

Mosfunksionimi i ‘Shansit të dytë’, program për arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën që prej viti 2013, penalizon akoma më shumë kontigjentin e fëmijëve të cilët e kanë braktisur shkollën vite më parë apo ata të cilët nuk janë regjistruar asnjëherë në sistemin arsimor bazë. Këta fëmijë, përpos dëshirës për tu integruar dhe vijuar arsimin bazë, përjetojnë një sërë problemesh emocionale dhe paragjykimesh, për shkak se rikthimi në po të njëjtën klasë që kanë braktisur vite më parë (mosha mendore) nuk përkon me moshën e tyre fizike. Të ndodhur përballë një fenomeni të tillë, këta fëmijë detyrohen të braktisin shkollën brenda një kohë shumë të shkurtër.

31 % të cilët kanë shprehur një qëndrim jo shumë pozitiv. Të pyetur për arsyet që çojnë në një vlerësim të tillë, përpos sjelljeve pro-sociale dhe mbështetëse të mësuesve ndaj fëmijëve të këtij komunteti, disa nga të anketuarit pohojnë se mësuesit kanë shpeshherë një qëndrim indiferent, shoqëruar me razicëm, diskriminim për shkak të ngjyrës së lëkurës, trajtim jo të njëjtë dhe të drejtë krahasuar me fëmijët e tjerë, mësimdhënie jo e përkushtuar ndaj këtij komuniteti, si edhe shoqëruar me ofendime verbale. Në fakt, ajo çfarë është problematike për sa i përket sjelljeve diskriminuese dhe segreguese është fakti i rrënjosjes së stereotipeve të tilla te vetë komuniteti shumicë. Edhe ato pak fëmijë me rezultate të mira nga komuniteti Rom janë përballur me stereotipat e mësuesve "edhe me ngjyrë edhe i zgjuar". Kjo tregon që duhet një punë dhe kohë më e gjatë që këto stereotipe të çrrënjosen nga mendësitë e komunitetit shumicë. E megjithatë, një pjesë mendojnë se mësuesit nuk bëjnë ndonjë diferencë në trajtimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë me fëmijët e tjerë.

## Punësimi, arsimi dhe formimi profesional (AFP)

Komuniteti Rom dhe ai Egjiptian në Shqipëri karakterizohen nga nivele të larta papunësie, ku dominon papunësia afatgjatë. Edhe kur anëtarë të komuniteteve raportojnë të jenë të punësuar, një sërë problematikash i ndjekin, si mungesa e kontratave të punës, mosmbulimi me sigurime shoqërore etj. Ndër arsyet kryesore që lidhen me këtë gjendje, në vite, janë evidentuar të jenë mungesa e mundësive për punësim në vendin tonë, niveli i ulët arsimor dhe diskriminimi me bazë përkatësinë etnike. Sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Shkodër, rezulton se numri total i romëve dhe egjiptianëve të regjistruar si punëkërkues në zyrën e punës për 2017 është 266, prej të cilëve 139 femra dhe 127 meshkuj. Ndërkohë, sipas të njëjtit burim zyrtar rezulton se 3 femra të komunitetit Rom dhe Egjiptian kanë

përfituar nga shërbimet e nxitjes së punësimit në Bashkinë Shkodër. Në Bashkinë e Shkodrës rreth 58% e romëve në moshë të aftë për punë deklarohen të papunë.

**A keni një punë të vazhdueshme?**




*Figura 4: A keni një punë të vazhdueshme? (IDM, 2017)*

Sipas studimit të UNDP (2016), në Shkodër, asnjë rom nuk e siguronte jetesën nga një pagë e rregullt, përkundrejt 13.9% tek egjiptianët. Pjesa më e madhe (44.4%) mbijetonin me anë të lypjes dhe 38.8% me të ardhura nga punë të përkohshme dhe me kohë të pjesshme.

Një situatë e ngjashme përshkruhet edhe nga të dhënat parësore të grumbulluara në kuadër të kësaj iniciative. Pjesa më e madhe e të intervistuarve raportojnë mungesën e një punësimi të vazhdueshëm dhe të rregullt. Problematika është edhe më e thellë, pasi edhe ata që punojnë raportojnë të jenë kryesisht të vetëpunësuar, me të ardhura të pamjaftueshme për jetesën (pjesë e fenomenit të të punësuarve të varfër). Për anëtarët e këtyre komuniteteve ka një përfshirje shumë të ulët edhe në sektorin publik. Ajo çfarë shqetëson tjetër këtë komunitet ka të bëjë gjithashtu me mundësitë shumë të ulëta për punësim në

tregun formal të punës. Vetëm 1.6% e të pyeturve punon në këtë sektor. Aktvitetet kryesore që raportojnë të kryejnë për mbijetesë janë lypja, riciklimi dhe punë të rastësishme.

Nga ana tjetër, mundësitë për lehtësimin e punësimit njihen dhe përdoren pak. Kjo qëndron edhe përsa i takon trajnimeve dhe kurseve profesionale, të konsideruara si një mundësi për lehtësimin e futjes së anëtarëve të komuniteteve rome dhe egjiptiane në tregun e punës. Sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Shkodër, rezulton se për vitin 2016 përfituan nga kurset profesionale rreth 6 romë dhe egjiptianë të papunë, prej të cilëve 3 ishin femra. Ndërkohë situata paraqitet e përkeqësuar për vitin 2017 pasi deri më tani nuk ka asnjë rom dhe egjiptian të regjistruar. Kurse më të frekuentuara nga komuniteti janë saldator, berber dhe mekanik makinash. Ndërkohë, për sa i përket punësimit të dhënat zyrtare paraqesin një tablo ende më të përkeqësuar, pasi për vitin 2016 ishin të punësuar vetëm 3 romë dhe egjiptianë, prej të cilëve 2 femra; si edhe për vitin 2017 janë të punësuar vetëm 2 femra nga komuniteti Rom dhe Egjiptian. Megjithatë, përpos diskriminimit të tyre në tregun e punës, në Shkodër ekzistojnë të paktën 19 biznese që dëshirojnë të punësojnë romë dhe egjiptianë (Gëdeshi et al, 2016).

Pavarësisht situatës, shumë pak njohin dhe regjistrohen në zyrat e punësimit si punëkërkues të papunë. Kryesisht pasi nuk kanë besim dhe nuk i njohin procedurat. Për pasojë, ata nuk njohin dhe nuk përfitojnë as nga mundësitë për kurse të formimit profesional. Kështu, më pak se 10% e të pyeturve kishin përfituar nga ky lloj shërbimi. Problematik është fakti i përjashtimit nga këto kurse profesionale për shkak të mos përmbushjes së kritereve bazë të arsimit bazik. Në përgjithësi ata deklarojnë se janë shumë pak optimist për efektin e tyre në krijimin e

mundësive për punësim (më shumë se gjysma e të pyeturve deklarojnë se nuk e dinë se çfarë dobie mund të sjellë frekuentimi i tyre).

**Si e vlerësoni gjendjen e përgjithshme të punësimit për komunitetin tuaj?**




*Figura 5: Perceptime mbi gjendjen e punësimit (IDM, 2017)*

Faktorët e mësipërm kanë rezultuar në një situatë aspak optimiste për punësimin dhe të ardhmen e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Shkodër. Vetë të pyeturit në sondazhin tonë, në masë dërrmuese, e vlerësojnë gjendjen e përgjithshme të punësimit në komunitetin e tyre si keq ose shumë keq. Nga intervistat e realizuara me anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian (IDM, 2017), rezulton se rreth 87% e tyre nuk kanë një punë të vazhdueshme. Pothuajse më shumë se gjysma e këtij komuniteti (55%) janë të vetëpunësuar kundrejt 5% që janë punësuar në sektorin publik, si edhe 10% janë të punësuar kryesisht në sektorin privat. Të dhënat e studimit të kryer nga Gëdeshi et al. (2016), tregojnë se 41.7% e romëve (44.4% meshkuj dhe 33.3 % femra) dhe 71.6% e egjiptianëve në Shkodër (71.2% meshkuj dhe 72.4% femra) janë duke kërkuar punë. Interesant është fakti se edhe pse përqindja e anëtarëve të komunitetit Egjiptian që kërkojnë punë është pothuajse

dy herë më e lartë se e romëve. Megjithatë, kjo shpesh mund të vijë për arsye të natyrës migratore që romët kanë në Bashkinë Shkodër. Duke filluar nga viti 2016, në Bashkinë Shkodër, 1 anëtar i komunitetit Rom dhe Egjiptian ka përfituar nga  programi i internshipeve në kuadër të projektit ESERE.

## Kujdesi shëndetësor

Në Shqipëri, gjendja shëndetësore e romëve dhe egjiptianëve është më e keqe se ajo e popullsisë në shumicë, gjë që rezulton edhe në një jetëgjatësi mesatare të tyre më të ulët (UNDP 2012). Shkaqet kryesore të kësaj situate lidhen me varfërinë, kushtet e vështira të jetesës dhe mungesën e infrastrukturës bazë, qasjen e kufizuar në shërbimet shëndetësore, nivelin e ulët arsimor dhe disa forma të diskriminimit.

Aksesi në shërbime shëndetësore kufizohet më shumë nga pengesa që nuk lidhen me infrastrukturën fizike dhe largësinë e qendrave që ofrojnë këto shërbime. Mungesa e kartave të shëndetit, korrupsioni i vogël dhe diskriminimi janë arsyet më madhore që raportohen të minimizojnë aksesin e anëtarëve të komuniteteve rome dhe egjiptiane në shërbime të shëndetit. Duke qenë se shumë anëtarë figurojnë të paregjistruar, kjo sjell pamundësinë për t'u mbështetur edhe me shërbime shëndetësore adekuate si qytetarë të Bashkisë Shkodër. Për shembull, nga intervista me staf të qendrës shëndetësore pranë komunitetit më të madh rom në Shkodër, nga 120 fëmijë të regjistruar pranë saj, nuk rezultonte i regjistruar asnjë fëmijë i këtij komuniteti. Përveç problemit të mospajisjes me libreza dhe kartela shëndetësore, tepër problematik është fakti i mosvaksinimit të fëmijëve të këtij komuniteti. Autoritetet shëndetësore shprehen se janë hasur me rezistenca nga ana e familjeve për mosvaksinim të fëmijëve.

## Si do ta vlerësonit në përgjithësi gjendjen shëndetësore në komunitetin tuaj?




*Figura 6: Perceptime mbi gjendjen e përgjithshme shëndetësore (IDM, 2017)*

Vlerësimi i Observatorit (2011) tregoi për mungesa të ujit të pijshëm në vendbanimet ku këto komunitete janë vendosur. Gjithashtu, edhe anëtarë të komunitetit Egjiptian në lagjen 'Liria' Shkodër kanë probleme me cilësinë e ujit të pijshëm, faktor i cili ndikon drejtëpërsëdrejti në shëndetin e tyre. Pajisja me libreza/karta të shëndetit përbën pengesën kryesore për akses të vazhdueshëm në shërbime shëndetësore. Kjo bën që të ketë inkonsistencë edhe në përkujdesin bazë siç është edhe vaksinimi i rregullt i fëmijëve. Personel i dedikuar për ndjekjen e tyre do ishte një alternativë e propozuar nga anëtarë të personelit aktual të qendrës shëndetësore. Vetë anëtarët e komuniteteve të intervistuar janë të ndërgjegjësuar për një gjendje jo të mirë shëndetësore të komuniteteve të tyre. Gjendja në komunitetin Rom dhe Egjiptian vlerësohet më pak se mesatare, siç tregohet edhe në grafikun e mëposhtëm. Aktualisht, numri i romëve dhe egjiptianëve të pajisur me karta shëndetësore në Bashkinë Shkodër nuk dihet.

Në përgjithësi, cilësia e shërbimeve shëndetësore raportohet se nuk është në standardet e duhura për t'ju përshtatur nevojave të komunitetit (Figura 4.11). Edhe pse aksesi në shërbimin shëndetësor parësor ofrohet falas në të gjitha qendrat shëndetësore, ky komunitet ka akses shumë të ulët në shërbimin e kujdesit parësor dhe atë të specialiteteve, shpeshherë kjo edhe për shkak të stilit të tyre të jetesës jo të shëndetshme dhe kushteve sociale ekonomike të cilat favorizojnë sëmundjet kronike. Për më tepër, aksesit të ulët dhe cilësisë jo të mirë të shërbimeve, i shtohen edhe forma direkte dhe indirekte të diskriminimit që perceptohen nga përfaqësues të komuniteteve rome dhe egjiptiane. Disa nga të intervistuarit shprehen për mungesën e aksesit të shërbimeve mjekësore, pamundësinë për të përfituar rimbursime të barnave, mungesën e pajisjes me karta shëndeti apo aksesin e ulët jo vetëm në shërbimet mjekësore parësore, por edhe në shërbimet e specialiteteve dhe terciale, kryesisht për shkak të pamundësisë ekonomike.

**Si e vlerësoni cilësinë e shërbimeve shëndetësore që ofrohen në zonën tuaj?**




*Figura7: Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore (IDM, 2017).*

Shërbimet shëndetësore nuk janë afër (Tabela 4.5) dhe korrupsioni në disa raste i largon ato jo vetëm fizikisht. Dhënia e ryshfetit për të marrë shërbim (më të mirë) është problem më i raportuar nga të pyeturit.

*Tabela 2: Distanca e shërbimeve shëndetësore nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane*

| Zona | Njësia administrative: Qendër | | |
|---|---|---|---|
| Institucioni | Qendër shëndetësore | Spital | Maternitet |
| | 1.1 | 1.6 | 1.6 |

Në përgjithësi, anëtarët e komuniteteve rome dhe egjiptiane shprehen pozitivisht (52% e vlerësojnë mirë dhe mesatar) sjelljen e stafit shëndetësor, megjithëse jo në pak raste hasen me neglizhencë. Ka një nevojë për përmirësim në sjelljen e stafit mjekësor në raport me nevojat e anëtarëve të komuniteteve rome dhe egjiptiane. Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapacitetit të tyre për ofrimin e shërbimeve, të zhveshura nga qëndrime dhe sjellje diskriminuese, është një element që duhet të ndiqet me masa konkrete.

## Strehimi dhe integrimi urban

Pas një përmirësimi të ndjeshëm të kushteve të strehimit dhe infrastrukturës për komunitetin Rom dhe Egjiptian gjatë viteve të diktaturës, të dhënat për periudhën që pasoi e në vijim, tregojnë një përkeqësim të ndjeshëm për ta. Sipas studimit të UNDP (2012) më shumë se 38% e familjeve rome dhe 45% e atyre egjiptiane banojnë në shtëpi të vjetra, ndërsa 21% e familjeve rome dhe 11% e atyre egjiptiane jetojnë në baraka. Shumë nga këto familje nuk kanë ujë të pijshëm, dhe kanalizime të ujërave të zeza në shtëpitë e tyre. Infrastruktura, në veçanti ajo afër vendbanimeve rome, karakterizohet nga rrugë të pashtruara ose rrugë në gjendje të keqe, ka probleme shqetësuese jo vetëm me

informalitetin e banesave por gjithashtu në lidhje me infrastrukturën rrugore, ndriçimin, probleme të cilat ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e jetesës së këtyre familjeve.
Ligji ka parashikuar tre programe sociale strehimi që janë:

(1) Programe të banesave sociale me qera.
(2) Programe të banesave me kosto të ulët.
(3) Programe të pajisjes së truallit me infrastrukturë. Përzgjidhet për t'u trajtuar me banesë me kosto të ulët, familja me të ardhurat maksimale mujore jo më të larta se 120% e të ardhurave mesatare të përcaktuara për prefekturën. Ligji ka parashikuar disa ndihma nga shteti për të pastrehët, ku përfshihen pesë kategori ndihmash si:
(1) Subvencionimi i qerasë. Përparësi në subvencionimin e qerasë ose përfitimin e bonusit të strehimit kanë kategoritë e mëposhtme dhe familjet e komunitetit Rom;
(2) Subvencionimi i interesave të kredive;
(3) Granti i menjëhershëm për banesat me kosto të ulët;
(4) Grantet e vogla.

Megjithatë, programet sociale të strehimit tërheqin familjet me të ardhura mesatare 6 deri në 8 herë më të larta se niveli i varfërisë. Të varfërit nuk mund t'i përballojnë banesat me kosto të ulët, prandaj ata nuk aplikojnë dhe nuk përfitojnë nga programi. Të varfërit kanë më tepër gjasa të përfitojnë nga banesat sociale me qera sesa nga banesat me kosto të ulët.

Për sa i përket të dhënave zyrtare, për vitin 2016 nuk është vënë në zbatim asnjë program social i strehimit dhe për rrjedhojë nuk ka asnjë përfitues. Për vitin 2017 parashikohet të zbatohen 2 programe sociale strehimi, respektivisht programi i banesave sociale me qera ku do sistemohen jetimët dhe gratë me urdhër mbrojtjeje me shumë fëmijë, në kushte të vështira socio–ekonomike me urdhër mbrojtjeje, si dhe

programi i bonusit të strehimit, për të cilin deri tani asnjë përfaqësues nga dy komunitetet nuk ka paraqitur aplikim edhe pse kanë prioritet më të madh në përfitim. Në vijim, është bërë e mundur rikonstruksioni i 9 banesave të komunitetit Rom dhe Egjiptian si edhe pritet të miratohet nga Ministria e Zhvillimit Urban projekti për rikonstruksionin e 35 banesave të tjera të komunitetit. Në total, në Bashkinë Shkodër janë rreth 1.912 familje që kanë aplikuar për strehim, por ndërkohë sistemi nuk mund të evidentojë familjet rome dhe egjiptiane, por thjesht realizon një klasifikim të përgjithshëm të të pastrehëve. Gjithashtu, Bashkia e Shkodrës ka vënë në dispozicion një truall rreth 30.000 m2, me qëllim ndërtimin e banesave sociale me qera posaçërisht për këto dy komunitete si dhe ka dorëzuar projektet respektive, për të cilat pritet përgjigje nga pushteti qendror dhe donatorët e huaj.

Një situatë e tillë vazhdon të dominojë strehimin dhe infrastrukturën e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Shkodër. Vetë banorët e këtij komuniteti në lagjen 'Liria' raportojnë të kenë furnizim me ujë të pijshëm (rreth 12 orë në ditë), shërbim nga i cili përfiton vetëm 50% e popullsisë së zonës në fjalë. Pjesa tjetër nuk kanë aspak akses në një shërbim të tillë dhe e sigurojnë ujin vetëm përmes shpimit të puseve. Aktualisht është hapur një pus shpimi që nxjerr ujë të pijshëm pranë fshatit të Paqes, si dhe janë instaluar 4 grupe çezmash publike në mënyrë që të lehtësohet aksesi sipas zonave. Sa i përket orarit me ujë të pijshëm, ai është i kufizuar dhe aksesohet në atë varg kohor që cilësohet si më i rëndësishëm dhe i nevojshëm gjatë ditës.

Situata është e ngjashme me kanalizimet e ujërave të zeza dhe furnizimin me energji elektrike ku vetem lagjia 'Liria' dhe 'Përtej Urës' rezulton të kenë disa elementë të këtyre shërbimeve bazë (20 puseta; 150 pompa dhe 150 gropa septike). Kanalizimi i ujërave të zeza është shumë problematik,

Edhe të pyeturit tanë në shumicë nuk e njohin dhe nuk kanë përfituar nga këto mundësi. Arsyet kryesore lidhem me:

- Mungesën e informacionit
- Mungesën e besimit
- Kriteret përjashtuese që vendosen për aksesimin e këtyre programeve.

**Si janë kushtet higjeno-sanitare në shtëpinë tuaj?**




*Figura 10: Vlerësimi i kushteve higjeno-sanitare (IDM, 2017)*

Ndërhyrjet më të mëdha dhe imediate vlerësohen të nevojiten në raport me përmirësimin e kanalizimeve, problematikës së përmbytjeve dhe furnizimin me ujë të pijshëm. Disa nga arsyet pse komuniteti Rom dhe Egjiptian ka një akses shumë të ulët ndaj shërbimeve të strehimit social ka të bëjë shpeshherë me mungesën e dokumentacionit të nevojshëm, vendbanimi jo i qëndrueshëm, përjashtimi i komunitetit nga tregu formal i punës, mungesa e të ardhurave minimale, mungesa e kapaciteteve të vetë institucioneve, kriteret përjashtuese që vendosen për aksesimin e këtyre programeve, mungesa e informacionit të duhur dhe arsimimi i ulët, mosregjistrimi civil.

## Mbrojtja sociale

Në Shqipëri, niveli i varfërisë i familjeve rome dhe egjiptiane është shumë i lartë dhe hendeku me pjesën tjetër të popullsisë ka ardhur duke u thelluar. Varfëria, shpeshherë e skajshme, e familjeve rome dhe egjiptiane i shtyn ato drejt izolimit dhe përjashtimit social, pasi ato janë më pak të afta të përballojnë nevojat e jetës së përditshme dhe kanë më pak mundësi të marrin pjesë në proceset që ndikojnë në jetën e tyre, të tilla si shkollimi, punësimi, aktivizimi politik etj. Në Bashkinë Shkodër, studimi i UNDP (2016) tregon se romët e kësaj zone, të gjithë, janë shumë të varfër. Ndërkohë, varfëria është dominuese edhe në familjet egjiptiane, por ndër to, ka rreth 7% që nuk rezultojnë të varfra.

Shumë familje rome dhe egjiptiane, për shkak të varfërisë, mbështeten edhe në burime të tjera alternative të ardhurash si ndihma ekonomike, pensionet për të moshuarit, pagesa e papunësisë, pagesa për aftësinë e kufizuar dhe pensionet për jetimët. Por këto transferta financiare nga qeveria janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat familjare, dhe për më tepër shumë familje rome e egjiptiane nuk kanë akses në këto përfitime si pasojë e mosinformimit dhe pamundësisë për të aplikuar për përfitimin e tyre.

Një situatë e tillë problematike karakterizon edhe komunitetin Rom dhe atë Egjiptian në Shkodër. Një pjesë e mirë e familjeve që do mund të kualifikoheshin si përfituese të ndihmës ekonomike nuk e përfitojnë atë si pasojë e mosregjistrimit të tyre në zyrën e gjendjes civile. Mungesa e regjistrimit e bën të pamundur zbatimin e Ligjit Nr. 9355 “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore” e për pasojë këto familje nuk mund të trajtohen nga skemat e Ndihmës Ekonomike dhe të përfitojnë shërbime të tjera publike. Kështu të dhënat zyrtare për Bashkinë Shkodër konfirmojnë se familjet rome janë thuajse totalisht të

përjashtuara nga këto përfitime. Për vitin 2016 raportohet se ndihmën ekonomike e kanë përfituar 122 familje rome dhe egjiptiane. Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike për vitin 2016 përfshin 84 fëmijë, kundrejt totalit të 4.849 (fëmijëve që ndjekin shkollën). Po kështu, pagesën e aftësisë së kufizuar për vitin 2016 e kanë përfituar vetëm 155 romë dhe egjiptianë. Për vitin 2017, rreth 123 familje rome dhe egjiptiane kanë përfituar nga ndihma ekonomike dhe rreth 157 romë dhe egjiptianë kanë përfituar nga skema e PAK.

Ndër të intervistuarit për qëllimet e kësaj iniciative, përfitimet që ata dhe familjet e tyre merrnin ishin siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

**A përfitoni ju apo familja juaj nga ndonjë prej shërbimeve të mëposhtme?**




*Figura 11: Përfitime nga programe dhe shërbime të mirëqenies sociale (IDM, 2017)*

Megjithatë, nevojat dhe kërkesat janë shumë më të mëdha si për sa i takon shtrirjes dhe mbulimit me shërbime, ashtu edhe për sa i takon cilësisë së tyre. Ndonëse, në përgjithësi, shërbimet marrin një vlerësim

mesatar për sa u takon cilësisë së tyre, ka shumë paqartësi dhe mungesë informimi mbi çfarë dhe si mund të përfitohet, që e bën aksesin në këto shërbime shumë më të kufizuar.

**Në ç'masë procesi i ofrimit të shërbimeve në programin e mbrojtjes sociale është i qartë dhe i kuptueshëm për ju?**




*Figura 12: Qartësia dhe kuptueshmëria e Programit (IDM, 2017)*

Nga ana tjetër, edhe kur anëtarë të komunitetit Rom apo Egjiptian i afrohen këtyre programeve dhe shërbimeve, ata rrallëherë marrin një orientim të mirë mbi kriteret dhe proceset që duhet të ndjekin. Rreth 37% e të intervistuarve deklaruan se nuk ishin orientuar asnjëherë mbi ndonjë prej programeve/shërbimeve që mund të përfitonin. Ndërkohë, aksesi ndaj ndihmës ekonomike bëhet më i vështirë duke marrë në konsideratë mangësitë në dokumentacionin përkatës për vendbanimet, transferimet e shpeshta të vendbanimeve apo problematikat mbi zotërimin e pronësisë ligjore mbi tokat. Përpos politikave të Bashkisë së Shkodrës për regjistrimin e romëve dhe vendbanimeve të tyre, situata paraqitet tepër problematike nëse i referohemi aksesit që ky komunitet ka në fushën e mbrojtjes sociale.

## Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Shkodër

kanë mundësi të barabarta dhe gjithëpërfshirëse nëpërmjet aksesit të përmirësuar në të gjitha shërbimet publike, me prioritet shërbimet e gjendjes civile dhe drejtësisë, në edukim dhe kujdes shëndetësor. Romët dhe egjiptianët përfitojnë më shumë nga programet e strehimit dhe mbrojtjes sociale, me kushte më të mira jetese nëpërmjet mundësive për punësim dhe punë të denjë, si dhe duke bashkëjetuar në komunitete më të fuqizuara lokale.

## Si do t'i vlerësonit këto shërbime?




*Figura 13: Qartësia dhe kuptueshmëria e Programit (IDM, 2017)*

Në këto kushte, shpesh, anëtarët e komunitetit Rom dhe atij Egjiptian përdorin kapitalin social për të përballuar disavantazhet e akumuluara nga varfëria dhe përjashtimi nga programet dhe shërbimet mundësuese. Sipas të dhënave të UNDP (2012) ata përshkruhen të jenë të pasur në kapital social konjitiv, por të varfër në kapital social strukturor, të tilla si shoqatat ose rrjetet që nxisin veprime kolektive. Fuqizimi i këtyre dimensioneve do të ndihmonte edhe fuqizimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian edhe në nivel lokal.

## Fëmijët në situatë rruge

Fëmijët në situatë rruge në Shqipëri identifikohen kryesisht si "fëmijë që punojnë", ku të gjitha fazat e studimit tregojnë se aktivitetet kryesore në rrugë ishin lypja dhe larja e xhamave të makinës, të ndjekura nga shitja në semaforë, në bare/kafene apo në pika të caktuara në anë të rrugës, ose shitja e shërbimeve të tilla si parkimi, puna si hamall apo riciklimi.

Një tjetër problematikë është edhe gjendja ekzistuese e fëmijëve në situatë rruge në Bashkinë Shkodër. Sipas të dhënave nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkinë e Shkodrës, janë identifikuar rreth 100 raste të këtyre fëmijëve të cilët në të shumtën e rasteve i përkasin komunitetit Rom. Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit tre ministrore «Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge» mes Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, është vendosur bashkëpunimi me gjithë strukturat përgjegjëse dhe është hartuar dhe miratuar Plani Lokal i Veprimit për Fëmijët në Situatë Rruge për Bashkinë Shkodër, ku janë të përcaktuara masat që duhet të ndërmerren, rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë strukturave publike dhe jopublike në mbrojtje të fëmijëve.

Për zbatimin e këtij Plani lokal është firmosur një Urdhër i Përbashkët «Për Zbatimin e Planit Lokal të Veprimit "Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge" 2016 – 2017" ndërmjet Bashkisë Shkodër, Drejtorisë Rajonale të Policisë së Qarkut Shkodër, Drejtorisë Arsimore Rajonale, Drejtorisë Rajonale të Punësimit, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Janë përcaktuar dhe janë ndërmarrë hapa konkretë në mbështetje të këtyre familjeve në zbatim të Udhëzuesit të procedurave për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe

referimin e fëmijëve në situatë rruge. Janë ngritur Skuadrat e Terrenit në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe Policinë, të cilat dalin në terren sipas një kalendari zyrtar të miratuar. Funksionojnë tre skuadra të terrenit në përbërje të së cilës janë përfaqësues të Bashkisë, organizatave dhe Policisë.

Puna me fëmijët në situatë rruge është një proces i vështirë ku kërkohet bashkëpunimi dhe kontributi i të gjitha strukturave përgjegjëse. Problematikë kryesore e familjeve dhe fëmijëve në situatë rruge në Bashkinë Shkodër është se këto familje janë kryesisht nga komuniteti Rom të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile të Bashkisë Shkodër, dhe një pjesë e madhe e tyre janë banorë të përkohshëm në territor. Për këtë arsye nuk mund të përfitojnë shërbime publike, si ndihmë ekonomike apo strehim. Për adresimin e nevojave të këtyre fëmijëve është hartuar një Plan ndërhyrje për secilën nga këto familje, si dhe është ofruar ndihmë duke i referuar në institucione dhe organizata për mbështetje, duke ofruar mundësi punësimi për disa prej tyre, edhe pse në asnjë rast puna e ofruar nuk është pranuar. Eshtë ofruar mbështetje administrative për regjistrimin në gjendjen civile apo përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbime të tjera publike, si dhe është mundësuar regjistrimi në shkollë dhe pajisja me librat, pajisjet shkollore dhe veshmbathje për një numër të konsiderueshëm të fëmijëve. Ndërhyrja në ndihmë të fëmijëve në situatë rruge duhet të bazohet në fuqizimin e familjes si mjedisi natyral për rritjen, mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijës. Prandaj është e nevojshme të krijohet një sistem i integruar dhe i koordinuar i masave dhe ndërhyrjeve për familjet dhe fëmijët në situatë rruge.



KAPITULLI 3

# PLANI I VEPRIMIT



## Deklarata e vizionit

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Shkodër kanë mundësi të barabarta dhe gjithëpërfshirëse nëpërmjet aksesit të përmirësuar në të gjitha shërbimet publike, me prioritet shërbimet e gjendjes civile dhe drejtësisë, në edukim dhe kujdes shëndetësor. Romët dhe egjiptianët përfitojnë më shumë nga programet e strehimit dhe mbrojtjes sociale, me kushte më të mira jetese nëpërmjet mundësive për punësim dhe punë të denjë, si dhe duke bashkëjetuar në komunitete më të fuqizuara lokale.

# Qëllimet strategjike dhe objektivat specifik

| Fushat Prioritare | Qëllimet Strategjike | Objektivat Specifik |
|---|---|---|
| Fusha prioritare 1.<br><br>Regjistrimi civil dhe aksesi në sistemin e drejtësisë | Qëllimi strategjik 1:<br><br>Romët dhe egjiptianët kanë akses në shërbimet e gjendjes civile dhe në sistemin e drejtësisë | Objektivi specifik 1.1:<br>Popullsia rome dhe egjiptiane ka akses të përmirësuar në shërbimet e gjendjes civile<br><br>Objektivi specifik 1.2:<br>Romët dhe egjiptianët përfitojnë nga ndihma ligjore falas dhe kanë akses të barabartë në shërbimet e drejtësisë |
| Fusha prioritare 2.<br><br>Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor | Qëllimi strategjik 1:<br><br>Rritja e nivelit arsimor për komunitetin Rom dhe Egjiptian si dhe promovimi i dialogut dhe harmonisë ndërkulturore | Objektivi specifik 2.1:<br>Rritja e numrit të fëmijëve të regjistruar nga komuniteti R/ E ndaj të gjitha niveleve të sistemit arsimor duke garantuar një arsim më cilësor<br>Objektivi specifik 2.2:<br>Mënjanimi i sjelljeve dhe qëndrimeve stigmatizuese dhe përjashtuese për fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian<br>Objektivi specifik 3<br>Rritja e kapaciteteve të institucioneve arsimore dhe vendore për të nxitur pjesëmarrjen dhe regjistrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në arsim<br>Objektivi specifik 4<br>Nxitja e dialogut ndërkulturor përmes aktiviteteve për promovimin e kulturave, identitetit Rom dhe Egjiptian dhe bashkëjetesës harmonike e trashëgimisë kulturore |
| Fusha prioritare 3.<br><br>Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP) | Qëllimi strategjik 1:<br><br>Romët dhe egjiptianët janë të fuqizuar ekonomikisht dhe integruar në tregun formal të punësimit, si dhe kanë një shkallë të lartë kualifikimi e ndërgjegjësimi për rëndësinë e arsimit profesional | Objektivi specifik 3.1:<br>Rritja e shkallës së punësimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian përmes programeve të nxitjes së punësimit dhe politikave proaktive të punësimit<br>Objektivi specifik 3.2:<br>Adresimi i papunësisë nëpërmjet promovimit të iniciativave komunitare dhe mbështetjes të skemave sipërmarrëse<br>Objektivi specifik 3.3:<br>Fuqizimi i romëve dhe egjiptianëve përmes përfshirjes më të madhe në arsimin profesional<br>Objektivi specifik 3.4:<br>Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Formimit Profesional dhe Zyrave të Punësimit |

| | | |
|---|---|---|
| Fusha prioritare 4.<br><br>Kujdesi Shëndetësor | Qëllimi strategjik 1:<br><br>Romët dhe egjiptianët gëzojnë shëndet më të mirë përmes aksesit më të plotë dhe cilësor në shërbimin mjekësor | Objektivi specifik 4.1:<br>Rritja e numrit të anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në shërbimet shëndetësore parësore (falas) si dhe dytësore dhe terciale më të përballueshme<br>Objektivi specifik 4.2:<br>Garantim i kujdesit shëndetësor më cilësor për nënat dhe foshnjat<br>Objektivi specifik 4.3.<br>Rritja e kapaciteteve të ekipit mjekësor/qendrave shëndetësore për informim dhe promovim më të madh të shërbimeve të shëndetit |
| Fusha prioritare 5.<br><br>Strehimi dhe Integrimi urban | Qëllimi strategjik 1:<br><br>Romët dhe egjiptianët kanë kushte të përmirësuara të strehimit | Objektivi specifik 5.1:<br>Rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në programet e strehimit social<br>Objektivi specifik 5.2:<br>Përmirësimi i kushteve infrastrukturore dhe higjeno-sanitare në vendbanimet dhe institucio-net ku ka përqëndrim të komunitetit Rom dhe Egjiptian |
| Fusha prioritare 6.<br><br>Mbrojtja sociale | Qëllimi strategjik 1:<br><br>Romët dhe egjiptianët kanë një mirëqenie më të mirë si rezultat i burimeve alternative të të ardhurave dhe shërbimeve sociale | Objektivi specifik 6.1:<br>Rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale<br>Objektivi specifik 6.2:<br>Rritja e efikasitetit të sistemit të mbrojtjes sociale<br>Objektivi specifik 6.3:<br>Rritja dhe përmirësimi i shërbimeve sociale të ofruara ndaj komunitetit R/E |

## 3.3 MATRICA

| Fusha prioritare:<br>Regjistrimi Civil dhe Aksesi në Sistemin e Drejtësisë | Indikatorët dhe treguesit e performancës: | | |
|---|---|---|---|
| Qëllimi strategjik 1:<br><br>Romët dhe egjiptianët kanë akses në shërbimet e gjendjes civile dhe në sistemin e drejtësisë | ➢ % e banorëve të intervistuar romë dhe egjiptianë që mendojnë se regjistrimi civil është shumë problem në komunitetin e tyre<br>➢ % e banorëve të intervistuar romë dhe egjiptianë që kanë patur nevojë për ndihmë ligjore falas dhe e kanë përfituar atë<br>➢ % e banorëve të intervistuar romë dhe egjiptianë që raportojnë se kanë anëtar në familje të paregjistruar në regjistrin civil<br>➢ % e banorëve të intervistuar romë dhe egjiptianë që raportojnë se nuk kanë informacion për ndihmën ligjore falas | ➢ 34% (2017) në 5-10% (2020)<br>➢ 10% (2017) në 30-50% (2020)<br>➢ 8% (2017) në 0% (2020)<br>➢ 38% (2017) në 10-20% më shumë në 2020 | |

Objektivi specifik 1
Popullsia rome dhe egjiptiane ka akses të përmirësuar në shërbimet e gjendjes civile

| Aktivitetet/hapat e veprimit | Insti-tucioni/ departa-menti | Periudha kohore | Kosto Lekë | Burimi i fi-nancimit | Indikatori | Treguesi bazë | Treguesi i synuar 2020 | Burimi i të dhënave |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.1 Fushata sensibilizuese që sigurojnë kuptueshmërinë për regjistrimin civil dhe transferimin e vendbanimeve | Drejtoria Ligjore (DL) e Gjendjes Civile (GJC)<br><br>Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit (DSHSS) | 2017-2019 | 10,000 | Bashkia Donatorë | Numri i fushatave<br>______<br>% e banorëve që shprehen se regjsitrimi civil është problem | Nuk ekziston<br>______<br>34% (IDM 2017) | 1 fushatë sensibilizuese<br>______<br>5-10 % | Raporti vjetor i Grupit Monitorimit dhe Vlerësimit të strategjisë (GMV) |
| 1.1.2 Ngritja e një strukture ndërsektoriale në nivel komunitar (SNK) me qëllim identifikimin, koordinimin, monitorimin dhe raportimin e rasteve për identifikimin dhe adresimin e çështjeve të regjsitrimit civil dhe problemeve të lejeve të banimit të familjeve rome dhe egjiptiane me përfaqësues të shërbimit shëndetësor, OSHC-ve, gjendjes civile, policisë administrator shoqëror, mësues, psikolog, punonjës social. | DSHSS<br>DL<br>GJC<br>Administratorë t ë Njësive Administrative (NJ.A) | 2018 | Pa kosto | Pa kosto | Grupi ndërsektorial funksional<br>______<br>% e anëtarëve r/e që shprehen se kanë anëtarë në famije të paregjistruar | Nuk ekziston<br>______<br>8% (IDM 2017) | Grupi i punës i ngritur si strukturë<br>______<br>0% | Raporti vjetor i GMV |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.3 Asistencë dhe ndihmë në transferimin e dokumentacionit të gjendjes civile për familjet në vështirësi ekonomike | Bashkia<br>OSHC | 2018-2020 | Pa kosto | Bashkia | Numri i rasteve të asistuara | 74 anëtarë të paregjistruar | 95-100 % e rasteve të asistuara | Raporti vjetor i GMV |
| 1.1.4 Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rome dhe egjiptiane që lehtësojnë dhe mbështesin aksesin në regjistrimin civil dhe në drejtësi | Bashkia | 2017-2020 | 200,000 /vit | Bashkia<br>Dona-torë | Mbështetja e organizatave | Nuk ekziston | Organizata të mbështetura | Raporti vjetor i GMV |
| 1.1.5 Organizimi i një aksioni për iden-tifikimin e romëve dhe egjiptianëve të paregjistruar në regjistrin e gjendjes civile & monitorim i individualizuar | Struktura ndërsek-toriale në nivel komu-nitar<br>Bashkia | 2017-2018 | Pa kosto | Pa kosto | Numri i rasteve të identifikuara që kërkojnë ndihmë për regjistrim civil<br>______________<br>% e banorëve që shprehen se nuk janë të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile<br>% e banorëve që shprehen se kanë anëtarë të familjes së tyre të paregjistruar | 74 raste të identifikuara<br>______________<br>12% (IDM, 2017)<br>______________<br>8% (IDM, 2017) | 80% e rasteve të identifikuara të zgjidhura<br>0%<br>______________<br>0% | Raporti vjetor i GMV |
| 1.1.6 Krijimi i struk-turave ndërmjetë-suese si instrumenta lehtësues, evidentues dhe mobilizues social të regjistrimit të lindjeve dhe të vendbanimit | Bashkia<br>Këshilli i Bashkisë | 2018 | Pa kosto | Pa kosto | Numri i strukturave ndërsektoriale në nivel komunitar | Nuk ekziston | 1 strukturë e ngritur | Bashkia |
| 1.1.7 Trajnime të personalizuara për anëtarët e strukturave ndërm-jetësuese | DL<br>GJC | 2018 | 10,000 | Bashkia<br>Donatorë | Numri i trajnimeve | Nuk ekziston | 1 trajnim i realizuar | Raporti vjetor i GMV |

| Objektivi specifik 2<br>Romët dhe egjiptianët përfitojnë nga ndihma ligjore falas dhe kanë akses të barabartë në shërbimet e drejtësisë | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.1 Koordinimi i iniciativave dhe mobilizimi i burimeve për ofrimin e shërbimit ligjor falas nga organizatat e shoqërisë civile | DSHSS<br>DL<br>GJC | 2018-2020 | 1,200 000/vit (part-time) | Bashkia<br>Donatorë | Ofrimi i shërbimit ligjor falas<br>______________<br>% e banorëve që shprehen se përfitojnë nga asistenca ligjore | Nuk ekziston<br>______________<br>10% kanë përfituar nga asistenca ligjore (IDM, 2017) | Shërbim ligjor falas 2017-2020<br>______________<br>30-50% | Raporti vjetor i GMV |
| 1.2.2 Krijimi i një databaze për rastet që kërkojnë asistencë ligjore dhe monitorimi i vazhdueshëm i rasteve | GJC<br>DSHSS<br>DL | 2017-2018 | Pa kosto | Pa kosto | Numri i anëtarëve në databazë | 74 raste të identifikuara për regjistrim në GJ.C | 100 % e rasteve të identifikuara në databazë | Raporti vjetor i GMV |
| 1.2.3 Ngritja e kapaciteteve të institucioneve vendore përmes trajnimeve të specializuara për dhënien e informacionit për ndihmën ligjore falas | GJC<br>DSHSS<br>DL | 2018-2020 | 20,000 | Bashkia<br>Donatorë | Numri i trajnimeve<br>______________<br>Numri i personave që trajnohen | Nuk ekziston<br>______________<br>Nuk ekziston | 2 trajnime për vit<br>______________<br>95-100 % e personave përgjegjës trajnohen | Raporti vjetor i GMV Raporti vjetor i GMV |
| 1.2.4 Informim dhe ndërgjegjësim në komunitet për Shërbimin e ndihmës ligjore | GJC<br>GJC<br>DL | 2018-2020 | 20,000 | Bashkia<br>Donatorë | Numri i takimeve në terren<br>______________<br>% e anëtarëve r/e që nuk njohin këtë shërbim | Nuk ekziston<br>______________<br>38% (IDM, 2017) | 2 fushata ndërgjegjësuese<br>______________<br>10-20% | Raporti vjetor i GMV |

| Fusha prioritare:<br>Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor | Indikatorët dhe treguesit e performancës: |
|---|---|
| Qëllimi strategjik 1:<br>Rritja e nivelit arsimor për komunitetin Rom dhe Egjiptian, si dhe promovimi i dialogut dhe harmonisë ndërkulturore | % e banorëve romë dhe egjiptianë që mendojnë se niveli arsimor i komunitetit të tyre është shumë mirë – nga 11% (2017) në 40% (2020)<br><br>% e banorëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian që raportojnë se nuk ka braktisje të shkollës/kopshtit nga fëmijët e komunitetit të tyre – 41% (2017) në 50-60% (2020)<br><br>% e banorëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian që raportojnë se fëmijët e tyre shkojnë në kopësht/shkollë – 61% (2017) në 85-90% (2020) |

Objektivi specifik 1
Rritja e numrit të fëmijëve të regjistruar nga Komuniteti R/ E ndaj të gjitha niveleve të sistemit arsimor duke garantuar një arsim më cilësor

| Aktivitetet/hapat e veprimit | Institucioni/ departa-menti | Periudha kohore | Kosto Lekë | Burimi i fi-nancimit | Indikatori | Treguesi bazë | Treguesi i synuar 2020 | Burimi i të dhënave |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.1 Informim dhe ndërgjegjësim i prindërve &komuniteteve rome dhe egjiptiane për rëndësinë e arsimit | Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR)<br><br>Drejtoria e Kulturës, Ar-simit, Rinisë dhe Sportit (DKARS)<br><br>Drejtoritë e Shkollave | 2017-2020 | Pa kosto | Pa kosto | Numri i fushatave<br><br>% e banorëvë që raportojnë se fëmijët e tyre shkojnë në kopësht/ shkollë<br><br>% e romëve dhe egjiptianëve që shprehen mirë dhe shumë mirë për nivelin arsimor të komunitetit të tyre (IDM 2017) | 9 fushata çdo vit shkollor pranë SHQK<br>61% (IDM, 2017)<br><br>11% (IDM, 2017) | 9 fushata ndërgjegjësuese në të gjitha shkollat 100% e shkollave<br>85-90%<br>85-90%<br><br>30-40 % deri në 2018<br>5-60 % deri në 2020 | Raporti vjetor i GMV |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.2 Hartimi i Planit të Veprimit për Bashkinë e Shkodrës "Çdo fëmijë Rom dhe Egjiptian në kopësht" me qëllim evidentimin, regjistrimin dhe frekuentimin e arsimit parashkollor nga fëmijët romë dhe egjiptianë | DAR<br>DKARS<br>Drejtoritë e Shkollave<br>Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve (DCK) | 2017-2018 | Pa kosto | Pa kosto | Hartimi i planit<br>Numri i fëmijëve r/e braktisës të shkollës për vitin 2026-2027<br>Numri i fëmijëve r/e braktisës të kopshtit për vitin 2016-2017 | Nuk ekziston<br>Nga 141 fëmijë romë të regjistruar 31% janë braktisës<br>Nuk ka braktisje nga fëmijët egjiptian (DAR, 2017)<br>Nga 45 fëmijë romë të regjistruar rreth 33% braktisën kopshtin<br>Nga 62 fëmijë egjiptian të regjistruar, 31% rezultuan braktisës (DAR, 2017) | Plan i hartuar dhe publik<br>10% ulje e shkallës së braktisjes<br>10% ulje e shkallës së braktisjes | Raporti vjetor i GMV |
| 2.1.3 Pilotim: ofrimi i shërbimit të vaktit ushqimor falas në sistemin parashkollor | Bashkia<br>DAR<br>DKARS<br>Drejtoria Ekonomike e Arsimit (DEA)<br>DCK | 2018-2020 | 420,000 për çdo vit (3,500 për çdo fëmijë në muaj) | Bashkia<br>DAR<br>Donatorë | Vakti ushqimor ofruar për fëmijët r/e<br>Numri i fëmijëve të regjistruar që përfitojnë nga vakti | Nuk ekziston<br>Nuk ekziston | Ofrimi i vaktit ushqimor<br>20 fëmijë përfitojnë nga vakti ushqimor | Raporti vjetor i GMV |
| 2.1.4 Mundësimi i ambienteve në shkolla për higjienën e fëmijëve të komunitetit r/e | DEA<br>DKARS | 2018-2019 | 600,000 | Bashkia<br>Donatorë | Mundësimi i ambienteve higjienike | Nuk ekzistojnë | Ambiente higjienike | Raporti vjetor i GMV |
| 2.1.5 Takime sensibilizuese me komunitetin për qasjen në arsim përmes bursave për komunitetin Rom dhe Egjiptian | Bashkia<br>DKARS<br>DSHSS<br>Drejtoritë e Shkollave | 2017-2020 | Pa kosto | Pa kosto | Numri i përfituesve të bursave për shkollë profesionale & universitet<br>Numri i fushatave informuese | Nuk ekziston<br>Nuk ekziston | 2 bursa të ofruara për shkollë profesionale<br>1 fushatë në vit për çdo shkollë | Raporti vjetor i GMV |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.6 Stimulimi alternativ për ndjekjen e shkollës nëpërmjet ofrimit të mjeteve didaktike/mësimore falas për nxënësit romë dhe egjiptianë që jetojnë në varfëri | DKARS<br>Qendra Ekonomike e Arsimit (DEA)<br>DSHSS | 2017-2020 | 1,000 për çdo nxënës | DAR<br>OSHC<br>Bashkia | Numri i nxënësve që kanë përfituar nga mjetet mësimore | Nuk ekziston | Mjetet të ofruara për 10-20% të fëmijëve romë/ egjiptianë | Raporti vjetor i GMV |
| 2.1.7 Organizimi i orëve ndihmëse/ plotësuese për nxënësit me rezultate të dobëta në mësime duke përfshirë vullnetarë dhe aktivist nga shoqëria civile | DAR | 2017-2020 | Pa kosto | Pa kosto | % e r/e që vlerësojnë rezultatet e dobëta në mësime shkak i braktisjes së shkollës | 46% (IDM, 2017) | 20-30 % | Raporti vjetor i GMV |
| 2.1.8 Riaktivizimi i 'Shansit të dytë', program për mënjanimin e braktisjes së shkollës së fëmijëve në nevojë ose/ dhe gjetja e alternativave përmes mobilizimit të OSHC | DAR | 2018-2020 | Pa kosto | DAR | Funksionimi i programit<br>______________________<br>% e fëmijëve romë egjiptianë të grupmoshës 8 deri 15 vjeç që ndjekin shkollën<br>------------------------<br>% e fëmijëve romë dhe egjiptianë të grupmoshës 8 deri 15 vjeç që nuk kanë shkuar asnjëherë në shkollë | Shansi i dytë nuk funksionon<br>______________________<br>39% e fëmijëve romë dhe 70.6% e fëmijëve egjiptianë<br>------------------------<br>39% e fëmijëve romë dhe 5% e fëmijëve egjiptianë | Funksionimi i Shansit të dytë<br>-----------------------------<br>10% rritje të frekuentimit të shkollës deri në 2018<br>20% deri në 2020<br>--------------------<br>5-10% e fëmijëve romë dhe 1-2 % e fëmijëve egjiptianë të grupmoshës 8 deri 15 vjeç që nuk kanë shkuar asnjëherë në shkollë, vijojnë shkollën | Raporti vjetor i GMV |
| 2.1.9 Identifikimi i rasteve të suksesshme në arsim dhe promovimi përmes medias | DSHSS<br>DAR<br>DKARS<br>Media lokale | 2017-2020 | Pa kosto | Pa kosto | Numri i rasteve të identifikuara & promovuar në webfaqen e DAR, në revistën e UNDP, në revistën e shkollave | Nuk ekziston | 2 raste të suksesshme të promovuara | Raporti vjetor i GMV |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.10 Nxitja e skemave nxitëse të përshkallëzuara për çdo fëmijë që regjistrohet në shkollë dhe përfundon nivele të ndryshme arsimi përmes mirëkoordinimit me OSHC, ndihmën ekonomike (pagesë kesh) | DKARS | 2017-2020 | 60.000 | Bashkia<br>Donatorë | % e r/e që vlerësojnë nevojën për të mbështetur prindërit për të fituar para<br>Numri i përfituesve nga skemat nxitëse | Nevoja për të mbështetur prindërit për të fituar para për jetesën është vlerësuar se ndikon shumë dhe jashtëzakonisht shumë në braktisjen e shkollës nga 66% r/e (IDM, 2017)<br>Nuk ekziston | Nevoja për të mbështetur prindërit për të fituar para për jetesën ndikon pak në braktisjen e shkollës - Reduktim me 10-20% deri në 2020<br>20 familje përfitojnë nga skemat | Raporti vjetor i GMV |
| 2.1.11 Zbatimi i penaliteteve për prindërit për mosrespektimin e ligjit për arsimin e detyrueshëm ( psh përjashtim nga skema lehtësuese/ bonuse) | DAR<br>Bashkia<br>Nj.A<br>PB | 2017-2020 | Pa kosto | Pa kosto | Numri i familjeve që regjistrojnë fëmijët pas penaliteteve | Nuk ekziston | 90% e rasteve | Raporti vjetor i GMV |
| Objektivi specifik 2<br>Mënjanimi i sjelljeve dhe qëndrimeve stigmatizuese dhe përjashtuese për fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian | | | | | | | | |
| 2.2.1 Fushata sensibilizuese dhe trajnime për parandalimin e qëndri-meve diskriminuese dhe përjashtuese në sistemin arsimor | DAR<br>DKARS<br>Drejtoritë e Shkollave | 2017-2020 | Pa kosto | Pa kosto | % e anëtarëve r/e që vlerësojnë se qëndrimet diskriminuese ndaj fëmijëve romë &egjiptianë ndikojnë në braktisjen e shkollës (IDM 2017)<br>Numri i fushatave | 38% (IDM,2017)<br>Nuk ekziston | 20% deri në 2018<br>10% deri në 2020<br>2 fushata në vit për çdo shkollë | Raporti vjetor i GMV |
| 2.2.2 Organizimi i aktiviteteve jashtëkurrikulare për promovimin e tolerancës ndërkulturore | Drejtoritë e Shkollave<br>DAR<br>DKARS | 2017-2020 | Pa kosto | Pa kosto | Numri i aktiviteteve | 1 herë në vit në çdo shkollë (DAR) | 2 herë në vit në çdo shkollë | Raporti vjetor i GMV |
| 2.2.3 Vendosja e masaveadministra-tive në rregulloret e brendshme të institucioneve arsimore për mësues dhe nxënës për raste diskriminimesh për shkak të etnisë | Drejtoritë e shkollave | 2017-2020 | Pa kosto | Pa kosto | Marrja e masave | Nuk ekziston | Rregullore e hartuar me masa administrative | Raporti vjetor i GMV |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektivi specifik 3<br>Rritja e kapaciteteve të institucioneve arsimore dhe vendore për të nxitur pjesëmarrjen dhe regjistrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në arsim | | | | | | | | |
| 2.3.1 Funksionimi dhe mbështetja e programit "Shkolla si Qendër Komunitare" duke mundësuar asistimin në përgatitjen mësimore dhe aktivitete jashtëkurrikulare | Drejtoritë e Shkollave<br>DAR | 2018-2020 | Pa kosto | Pa kosto | Numri i nxënësve që përfitojnë nga programi | 14 Shkolla përfitojnë nga programi (DAR) | 16 shkolla përfitojnë nga programi | DAR |
| 2.3.2 Trajnimi i mësuesve për të adresuar me efikasitet nevojat e fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian | DAR<br>DKARS | 2018-2020 | 30000 | Bashkia<br>Dontarë | Nr. i trajnimeve | Nuk ekziston | 2 trajnime të mësuesve çdo vit | Raporti vjetor i GMV |
| 2.3.3 Ngritja e një strukture koordinuese nga staf i specializuar multidisiplinar (drejtorë të institucioneve arsimore, mësues kujdestar, psikolog, punonjës social, NJMF) për identifikimin e fëmijëve që kanë braktisur shkollën dhe regjistrimi i tyre<br>duke parashikuar vizita në komunitet dhe familje | DAR<br>NJMF<br>PB<br>DKARS<br>Njësia e Menaxhimit të Qendrave Komunitare (NJMQK ) | 2017-2018 | Pa koso | Pa kosto | Ngritja e një strukture<br>__________<br>% e anëtarëve që vlerësojnë se ka braktisje të shkollës/ kopshtit nga fëmijët romë dhe egjiptianë<br>__________<br>Numri i fëmijëve r/e braktisës të shkollës për vitin 2016-2017 | Nuk ekziston<br>__________<br>41% (IDM, 2017)<br>__________<br>Nga 141 fëmijë romë të regjistruar 31% janë braktisës<br>Nuk ka braktisje nga fëmijët egjiptianë<br>(DAR, 2017) | Struktura e ngritur<br>__________<br>Reduktim me 20-25% për nivelin e braktisjes<br>__________<br>10% ulje e shkallës së braktisjes | Raporti vjetor i GMV |
| 2.3.4 Ngritja e një skeme monitorimi & raportimi për fëmijët që kanë braktisur shkollën ( apo rrezikojnë të bëhen pjesë e këtij kontigjenti) dhe ndjekja e personalizuar dhe ndërhyrja ndërsektoriale për këta fëmijë | Struktura Koordinuese | 2017-2020 | Pa kosto | Pa kosto | Ngritja e skemës<br>__________<br>% e anëtarëve vetëraportojnë braktisje të shkollës nga fëmijët e komunitetit | Nuk ekziston<br>__________<br>41% (IDM 2017) | Skema monitorimi e ngritur<br>__________<br>Ulje me 20-25% deri në 2020 | Raporti vjetor i GMV |
| 2.3.5 Rikonstruksione të pjesshme në institucione arsimore në zonat ku ka përqëndrim të komunitetit Rom dhe Egjiptian kanë nevojë për ndërhyrje emergjente. | Bashkia | 2017-2018 | Grant i Bashkisë | Donatorë<br>Bashkia | Numri i shkollave/ kopshteve të rikonstruktuara<br>__________<br>% e të anketuarve që shprehen mirë për kushtet e mësimdhënies në shkolla dhe në kopshte | Nuk ekziston<br>__________<br>28% - shkolla<br>15% - kopshte<br>(IDM, 2017) | Institucione të rikonstruktuara<br>__________<br>50% e të anketuarve shprehen mirë për kushtet e mësimdhënies në shkolla dhe 30% shprehen mirë për kushtet në kopshte | Raporti vjetor i GMV |

| Objektivi specifik 4<br>Nxitja e dialogut ndërkulturor përmes aktiviteteve për promovimin e kulturave, identitetit Rom dhe Egjiptian dhe bashkëjetesës harmonike e trashëgimisë kulturore | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.4.1 Organizimi i aktiviteteve që promovojnë kulturën dhe trashëgiminë kulturore rome dhe egjiptiane/ java e kulturës Rome/Egjiptiane ( 2-8 Prill), ku të organizohen evente dhe promovime të ndryshme | DAR<br>Drejtoritë e Shkollave<br>DKARS<br>NJMQK | 2017-2020 | 30,000 | Donatorë<br>Bashkia | Numri i aktiviteteve të organizuara | 1 aktivitet në vit (DAR) | 2 aktivitete në vit për çdo shkollë | Raporti vjetor i GMV |
| 2.4.2 Ngritja e një platforme bashkëpunimi dhe koordinimi mes aktorëve të OSHC, donatorëve dhe aktorëve publik që promovojnë dhe mbështesin diversitetin dhe dialogun ndërkulturor | DAR<br>DKARS<br>NJMQK | 2018-2020 | Pa kosto | Pa kosto | Ngritja e platformës<br>Kalendar takimesh koordinuese<br>Plan pune me aktivitete konkrete të promovimit të diversitetit dhe dialogut ndërkulturor | Nuk ekziston | Platformë funksionale e ngritur<br>Të paktën 2 takime në vit<br>Të paktën një aktivitet promovues në vit | Raporti vjetor i GMV |
| 2.4.3 Organizimi i një panairi ndërkulturor 8 Prill me bazë punime artizanati dhe etnokulturore, artistike | Bashkia<br>NJMQK | 2017-2020 | 60,000 | Donatorë<br>Bashkia | Organizimi i panairit<br>% e banorëvë romë dhe egjiptianë që shprehen se nuk kanë hasur asnjëherë qëndrime diskriminuese në institucionet lokale | Nuk ekziston<br>39% (IDM, 2017) | 1 panair i organizuar për vit<br>70-75% | Raporti vjetor i GMV |
| 2.4.4 Zhvillimi i aktiviteteve edukuese, sensibilizuese që promovojnë identitetin Rom dhe Egjiptian dhe bashkëjetesën harmonike; programeve dhe projekteve mbi diversitetin si shumëllojshmëri dhe jo si dallim | DKARS<br>DSHSS<br>NJMQK | 2017-2020 | 20,000 | Donatorë<br>Bashkia | % e anëtarëve që vlerësojnë se sjelljet e stafit mësimor/edukativ në shkollën/kopshtin e lagjes së fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian janë të një natyre shumë të mirë<br>Numri i veprimtarive të organizuara | 1.6% (IDM, 2017)<br>Nuk ekziston | 50% deri në 2020<br>4 veprimtari të organizuara | Raporti vjetor i GMV |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.4.5 Ofrimi i lehtësirave për shfrytëzimin e hapsirave (pa pag-esë) për klubet sportive apo rinore nga anëtarë të komunitetit R/E | DKARS | 2017-2020 | Pa kosto | Pa kosto | Numri i aktiviteteve | Nuk ekziston | Ambiente lehtësisht të shfrytëzueshme | Raporti vjetor i GMV |
| 2.4.6 Organizimi i kampeve verore për fëmijët r/e | OSHC<br>Bashkia<br>NJMQK | 2017-2020 | 60,000 çdo vit | Donatorë | Numri i fëmijëve që frekuentojnë kampet | Nuk ekziston | 80 fëmijë përfitues | Raporti vjetor i GMV |
| 2.4.7 Ndërmarrja e fushatave të ndry-shme sensibilizuese për punonjësit e institucioneve të pushtetit lokal mbi përfshirjen sociale të komuniteteve rome dhe egjiptiane & paranda-limin e sjelljeve dhe qëndrimeve segreguese | DKARS<br>DSHSS<br>NJMQK | Pa kosto | Pa kosto | Pa kosto | % e banorëvë romë dhe egjiptianë që shprehen se kanë hasur qëndrime diskriminuese në institucionet lokale | 28% (IDM, 2017) | 5-10% | Raporti vjetor i GMV |

| Fusha prioritare:<br>Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP) | Indikatorët dhe treguesit e performancës: |
|---|---|
